



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr.1311/4 prot.

Datë 11.07.2023

**V E N D I M**  
**Nr. 594/2023**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 11.07.2023 shqyrtoi kërkesën me:

**Objekt:**

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Armand Sinani” PF në procedurën e prokurimit “*Procedurë e kufizuar*”, me Nr. REF-67127-04-25-2023, me objekt: “*Blerje këpucë për Gardën e Republikës*” me fond limit **29,995,279** (njëzet e nëntë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e pesë mijë e dyqind e shtatëdhjetë e nëntë) lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 16.05.2023 nga autoriteti kontraktor, Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara.”

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Gentian Sadiku” PF në procedurën e prokurimit “*Procedurë e kufizuar*”, me Nr. REF-67127-04-25-2023, me objekt: “*Blerje këpucë për Gardën e Republikës*” me fond limit **29,995,279** (njëzet e nëntë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e pesë mijë e dyqind e shtatëdhjetë e nëntë) lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 16.05.2023 nga autoriteti kontraktor, Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara.

**Ankimues:**

“Armand Sinani” PF  
Njësia Bashkiake Nr.9, rruga “Jordan Misja”, Kompleksi  
“Gener 2”, kati 1, Parkimi Nr.29, Tiranë

“Gentian Sadiku” PF

Rruga “Tom Plezha”, Pallati Milo, Nr.7, Zona Kadastrale 3866, Pasuri 298/211-N11, Yzberisht, Kashar, Tiranë

**Autoriteti Kontraktor:** Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara.  
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Nd. 1, 1001, Tiranë

**Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesve, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

## V ë r e n:

### I

#### *Vlerësimi paraprak*

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatorët ekonomikë kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të. Gjithashtu, KPP konstatoi se ankesat e operatorëve ekonomikë janë paraqitur për të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

I.3. Operatori ekonomik ankimues “Armand Sinani” PF, ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

I.4 Operatori ekonomikë ankimues “Gentian Sadiku” PF, nuk ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

## II

### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 26.04.2023 në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “*Procedurë e kufizuar*”, me Nr. REF-67127-04-25-2023, me objekt: “*Blerje këpucë për Gardën e Republikës*” me fond limit 29,995,279.00 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 16.05.2023 nga autoriteti kontraktor, Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara”.

II.2. Në datën 16.05.2023, autoriteti kontraktor ka zhvilluar fazën e parë (shprehje interesi) të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, ku konstatohet se kanë shprehur interesin këto operatorë ekonomikë:

- “Arisa Konfeksion” Skualifikuar
- “Armand Sinani ” PF Skualifikuar
- “Gentian Sadiku” PF Skualifikuar

II.3. Në datën 01.06.2023, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë, mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, (short listing) ku rezultoni si më poshtë vijon:

Arisa Konfeksion”	Skualifikuar
Armand Sinani ” PF	Skualifikuar
Gentian Sadiku” PF	Skualifikuar

II.4. Në datën 01.06.2023 operatori ekonomik “Armand Sinani” PF është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave, si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi me argumentet si më poshtë vijon:

*Operatori ekonomik nuk ploteson kërkesa sipas pikën 6, te seksionit 2.3 “Kapaciteti teknik” të Kriterëve të Vecanta të Kualifikimit në lidhje me tabelën që specifikon nëse është prodhues apo distributor , vendin e origjinës si dhe certifikimet te leshuara.*

*Konkretisht për këtë pikë operatori ekonomik ka paraqitur tabelën duke deklaruar se do të jetë prodhues i artikujve objekt i prokurimit, mirepo nga shqyrtimi i të dhënave në QKB rezulton se ky operator nuk ka fabrikë për prodhimin e këpucëve por disponon vetëm një zyrë për aktivitetin e subjektit. Gjithashtu edhe referuar pasqyrave financiare të vitit të fundit të aktivitetit 2022, zëri “impiante dhe makineri” nuk ka te dhena mbi disponimin e një kapaciteti prodhues që do të mundësonte OE të realizonte objektin e prokurimit prodhimin e kepuceve. Në zbatim të paragrafit te fundit të shtojcës 9 të DST “rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim”, dokumentacioni per këtë pikë nuk pranohet.*

- Operatori Ekonomik nuk plotëson pikën 8, te seksionit 2.3 “Kapaciteti teknik” të Kriterëve të Vecanta të Kualifikimit në DST, ku përcaktohet se “Operatori ekonomik duhet të paraqesë fletë analize laboratorike të cilat duhet të jenë të realizuara nga laboratorë të akredituar sipas akreditimeve kombëtare dhe/ose ndërkombëtare. Këto testime duhet të jenë në përputhje të plotë me specifikimet teknike”, pasi në fletë analizat laboratorike të paraqitura, mungojnë të dhëna të rëndësishme të specifikimeve teknike Shtojca 7 e DST, për të 3 llojet e kepuceve objekt i prokurimit, si më poshtë vijon:

1. “Këpucë gjysma uniforme”

Në fletë analizat e paraqitura për këtë objekt përkatësisht Nr. A2-37, L2-35, A2-2H, A2-38, L2-36, L2-33, L2-34, L2-42, A2-41, L2-39, A2-40, dhe Nr.L2-37, mungojnë të dhënat për këto zëra: Artikulli “MESHINE dhie – cilesia e pare per astarin e faqes, lapetes, mbrapshtines dhe shtrojes me trashesi”

- Zgjatimi në ngarkesë 15 – 30 % nuk ka të dhëna në analize
- Penje-Sintetike me fortësi 38 kg(4hapa në 3 cm) për qepjen brenda jashtë të fjalës me tabanin, nuk ka të dhëna në analize
- penj sintetike me ngjyrë të zezë me rezistencë mbi 9 kg Nr 40/3 për masurën dhe 30/3 për qepjen e suprines (veshet,mbrapshtines, filetove dhe tegelave të tjere të faqes së këpucës). nuk ka të dhëna në analize
- Bombe material termoplastik me trashësi jo më pak se 1 mm. nuk ka të dhëna në analize
- Forte material termoplastik me trashësi jo më pak se 1 mm . nuk ka të dhëna në analize

B:Pjesa e poshtme e këpucës. NUK KA TË DHËNA NË ANALIZË për të gjithë treguesit më poshtë:

- Sholle gome kompakte e presuar (pjesa e poshtme e kepuces) me trashësi 9–10 mm nga e cila  $2 \pm 0.5$  mm të jete trashësia e kanaleve ose e luleve (reliev kundër rreshqitjes). nuk ka të dhëna në analize
- Taban– Solete (lekure natyrale) me trashësi  $3 \pm 0.5$  mm. nuk ka të dhëna në analize
- Fjap gome e presuar me trashësi  $3 \pm 0.5$  mm. nuk ka të dhëna në analize
- Xhiro gome e presuar me pjerresë konike e gjerësi 17-19 mm. nuk ka të dhëna në analize
- Taka gome e presuar me lartësi 2.8 –3 cm (se bashku me gomen e fjalës që shoqërohet me xhiro) nuk ka të dhëna në analize
- Ngjites 1 komponent për ngjitjen e fjalës me tabanin dhe ngjites 2 komponente për ngjitjen e fjalës me shollen.Ngjitja të jete shumë e mirë. nuk ka të dhëna në analize.

Treguesit cilësorë të pjesës së poshtme :

- Fortësia në gradë shore për “Shoje të presuar” të jete  $73 \pm 3$  nuk ka të dhëna në analize
- Fortësia në gradë shore për “Fjap të presuar” të jete  $80 \pm 5$ . nuk ka të dhëna në analize

2. “Këpucë me qafa dimërore” për punonjësit e Gardës së Republikës.

Në fletë analizat e paraqitura për këtë objekt përkatësisht Nr.A2-40 mungojnë të dhënat për zërat.

**PËRFORCUES:**

- Material termoplastik (forti) që nuk thyhet: Trashësia  $1.4\text{mm}\pm 0.1\text{mm}$
- Material termoplastik (bombeja) që nuk thyhet: Trashësia  $1.2\text{mm}\pm 0.1\text{mm}$
- Material përforcues për pjesën e vrimave tek veshët

3. “Këpucë me qafa shërbimi e stërvitje” për punonjësit e Gardës së Republikës.

Në fletë analizat e paraqitura për këtë objekt përkatësisht Nr. A2-37, L2-35, A2-2H, A2-38, L2-36, L2-33, L2-34, L2-42, A2-41, L2-39, A2-40, dhe Nr.L2-37, mungojnë të dhënat për këto zëra:

**LENDET NDIHMESE** nuk të dhëna në analiza si më poshtë vijon:

- Ngjitësa me 1 komponente dhe për ngjitjen e pjesës së poshtme (sholles me fjalapen) me 2 komponente.
- Penj sintetik me ngjyre të zeze për qepje e lekures 100 % sinetik dhe qëndrueshmeri mbi 9 kG, për masurin Nm 40/3 dhe gjilperen Nm 30/3
- Penj sintetik i thurur 1 mm për qepje 100 % PES dhe rezistence 38 kG (1000 g)
- Bombe termoplastike me trashësi 1.4 deri 1.7 mm.
- Forte soleti me trashësi 2.5-3.2mm.
- Taban soleti me trashësi 3 deri 3.5 mm.
- Fjalap gome me trashësi 4 deri 4.2 mm, e shoqëruar me xhiro gome me pjerresi konike dhe gjeresi të saj 17-19 mm. sipas STASH 2896–87
- Pjesa e poshtme të jete gome e presuar me fortesi 75 +/-3 grade shore (sipas STASH 2638-87), cilesia e pare. Goma e presuar poshte të jete e dhembëzuar ose me lule në pjesën me llokma trashësia të jete 13-14 mm ndërsa pa llokma trashësia të jete 7-8 mm.
- Astar shtroje karton fiber me trashësi 1.4 – 1.7 mm.
- Kamarete e kurbeuar me gjeresi 17 –20 mm dhe gjatesi sa 1/3 e gjatesise se kepuces.
- Rezistenca në shqitje e gomes: shume e mire sipas (STASH 1150/8-89).
- Percaktimi i qëndrueshmerise se ngjyres: Në të thate nuk lejohet çngjyrosja (STASH 1150/7-89).
- Sfungjer për qafën e këpucës me trashësi 6 mm
- Sfungjer për mbushjen e lapetës me trashësi 3 mm

II.5. Në datën 07.06.2023 pranë Komisionit të Prokurimit Publik është administruar ankesa me nr. 1311 protokollit e operatorit ekonomik “Armand Sinani” SHPK për procedurën e prokurimit. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Armand Sinani” PF.

II.5.1. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. 1311/2 prot., datë

08.06.2023 lidhur me arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues “Armand Sinani” PF.

II.5.2. Me anë të shkresës Nr.823/4 prot., datë 14.06.2023, protokolluar me tonën me nr. 1311/3 prot., datë 19.06.2023, autoriteti kontraktor ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacion mbi procedurën e mësipërme të prokurimit si dhe aktin e trajtimit të ankesës të operatorit ekonomik “Armand Sinani” PF, ku konstatohet se ankesa e këtij të fundit është refuzuar.

II.6. Operatori ekonomik ankimues “Gentian Sadiku” PF është skualifikuar për arsyet si më poshtë vijon:

*Operatori Ekonomik nuk plotëson pikën 8, te seksionit 2.3 “Kapaciteti teknik” të Kriterëve të Vecanta të Kualifikimit në DST, ku përcaktohet se “ Operatori ekonomik duhet te paraqese fletë analize laboratorike të cilat duhet të jenë të realizuara nga laboratorë të akredituar sipas akreditimeve kombëtare dhe/ose ndërkombëtare. Këto testime duhet të jenë në përputhje te plotë me specifikimet teknike”, pasi në fletë analizat laboratorike të paraqitura, mungojnë të dhëna të rëndësishme të specifikimeve teknike Shtojca 7 e DST,per të 3 llojet e kepuceve objekt i prokurimit, si më poshtë vijon:*

*Janë paraqitur 5 fletë analiza: L2-47 (analizë lëkurë vici këpucë me qafa), L2-46( analizë Astar Kepuce me qafa dimerore ), L2-44 (analizë Astar këpucë gjysma) L2-43 (analizë Lëkurë këpucë gjysma), L2-45 (analizë Lëkurë këpucë me qafa dimërore).*

*1. “Këpucë gjysma uniforme” për artikullin “Meshine dhie – cilesia e pare per astarin e faqes, lapetes, mbrapshtines dhe shtrojes me trashesi 0.9 – 1.2 mm. (STASH -1144-89)”, mungojnë të dhënat ne analiza për zërat*

*- zgjatimi në ngarkesë 15 – 30 % nuk ka te dhena ne analize*

*- Penje-Sintetike me fortesi 38 kg(4hapa ne 3 cm) per qepjen brenda jashte të fjapes me tabanin, nuk ka*

*-penj sintetike me ngjyrë të zezë me reziztence mbi 9 kg Nr 40/3 për masuren dhe 30/3 për qepjen e suprines (veshet, mbrapshtines, filetove dhe tegelave të tjere të faqes së këpucës).*

*nuk ka te dhena ne analize*

*-Bombe material termoplastik me trashesi jo me pak se 1 mm. nuk ka te dhena ne analize*

*-Forte material termoplastik me trashesi jo me pak se 1 mm . nuk ka te dhena ne analize*

*-Sholle gome kompakte e presuar (pjesa e poshtme e kepuces) me trashesi 9–10 mm nga e cila 2+/-0.5 mm te jete trashesia e kanaleve ose e luleve (reliev kunder rreshqitjes).*

*nuk ka te dhena ne analize*

*-Taban– Solete (lekure natyrale) me trashesi 3+/-05 mm.*

*nuk ka te dhena ne analize*

*-Fjap gome e presuar me trashesi 3+/-05 mm.*

*nuk ka te dhena ne analize*

*-Xhiro gome e presuar me pjerresi konike e gjeresi 17-19 mm.*

*nuk ka te dhena ne analize*

*-Taka gome e presuar me lartesi 2.8 –3 cm (se bashku me gomen e fjapen qe shoqerohet me xhiro) nuk ka te dhena ne analize*

*-Ngjites 1 komponent per ngjitjen e fjapes me tabanin dhe ngjites 2 komponente per ngjitjen e fjapes me shollen.Ngjitja te jete shume e mire.*

*nuk ka te dhena ne analize*

*Treguesit cilesore te pjeses se poshteme :*

*-Fortesia ne grade shore per “Shoje te presuar” te jete 73+/-3*

*nuk ka te dhena ne analize*

*-Fortesia ne grade shore per “Fiap te presuar” te jete 80+/-5.*

*nuk ka te dhena ne anlize*

## *2. “Këpucë me qafa dimërore”*

*Në fletë analizat e paraqitura për këtë objekt përkatësisht Nr. L2-46 dhe Nr.L2-47, mungojnë të dhënat për zërat e specifikimeve si vijon:*

*SHOLLA: gomë e presuar me relief kundër rrëshqitjes*

*- Ngjyra: e zezë*

*- Lartësia: 7-8 mm tek maja, rreth 38 mm tek taka*

*- Rezistenca në këputje: jo më pak se 17 MPa*

*- Konsumi: jo më shumë se 150 mm<sup>3</sup>*

*- Fortësia: 750 Shore ±3*

*- Masa vëllimore: 1.2 g/cm<sup>3</sup>*

*- MATERIALET PËR SHTROJËN:*

*- Karton kompakt i presuar: Me përbërje Celulozë, trashësia 1.9-2 mm*

*- Karton fibër i presuar: Me përmasa 14 - 15 cm, gjerësia 6.4-6.5 cm, forma sipas tabanit.*

*- Material për pjesën e shtrojës: Sfungjer i hollë (memory foam), me përmasa 4 - 6 mm.*

*- Kamaretë metalike: Shirit çeliku i kanalizuar me nervaturë, me përmasa 14 - 15 cm, me gjerësi 8 – 10 mm.*

*PËRFORCUES:*

*- Material termoplastik (forti) që nuk thyhet: Trashësia 1.4mm±0.1mm*

*- Material termoplastik (bombeja) që nuk thyhet: Trashësia 1.2mm±0.1mm*

*- Material përforcues për pjesën e vrimave tek veshët*

## *3. “Këpucë me qafa shërbimi e stërvitje” për punonjësit e Gardës së Republikës.*

*Në fletë analizat e paraqitura për këtë objekt përkatësisht Nr.l2-47 mungojnë të dhënat për zërat si më poshtë vijon*

*· ASTARI per te gjitha pjeset e brendeshme te jete meshin dhije,me keto te dhena (sipas STASH 1144 – 89) :*

*- zgjatimi ne ngarkese 15 – 30 %*

*- Ngjitesa me 1 komponente dhe per ngjitjen e pjeses se poshteme (sholles me fjapen) me 2 komponente.*

*- Penj sintetik me ngjyre te zeze per qepje e lekures 100 % sineteik dhe qendrueshmeri mbi 9 kG,per masurin Nm 40/3 dhe gjilperen Nm 30/3*

*- Penj sintetik i thurur 1 mm per qepje 100 % PES dhe rezistence 38 kG (1000 g)*

*- Bombe termoplastike me trashesi 1.4 deri 1.7 mm.*

*- Forte soleti me trashesi 2.5-3.2mm.*

*- Taban soleti me trashesi 3 deri 3.5 mm.*

*- Fjap gome me trashesi 4 deri 4.2 mm, e shoqeruar me xhiro gome me pjerresi konike dhe gjeresi te saj 17-19 mm. sipas STASH 2896–87*

*- Pjesa e poshtme te jete gome e presuar me fortesi 75 +/-3 grade shore (sipas STASH 2638-87), cilesia e pare. Goma e presuar poshte te jete e dhembezuar ose me lule ne pjesen me llokma trashesia te jete 13-14 mm ndersa pa llokma trashesia te jete 7-8 mm.*

- Astar shtroje karton fiber me trashesi 1.4 – 1.7 mm.
- Kamarete e kurbeuar me gjeresi 17 –20 mm dhe gjatesi sa 1/3 e gjatesise se kepuces.
- Rezistenca ne shqitje e gomes: shume e mire sipas (STASH 1150/8-89).
- Percaktimi i qendrueshmerise se ngjyres: Ne te thate nuk lejohet çngjyrosja (STASH 1150/7-89).
- Sfungjer për qafën e këpucës me trashësi 6 mm
- Sfungjer për mbushjen e lapetës me trashësi 3 mm

II.6.1. Në datën 12.06.2023 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është protokolluar ankesa me nr.1339 prot., e operatorit ekonomik “Gentian Sadiku” PF, në lidhje me procedurën e prokurimit. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “Gentian Sadiku” PF.

II.6.2. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. 1339/2 prot., datë 13.06.2023 lidhur me arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues “Gentian Sadiku” PF në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.6.3. Me anë të shkresës Nr. 834/4 prot., datë 20.06.2023, protokolluar me tonën me nr. 1339/3 prot., datë 21.06.2023, autoriteti kontraktor ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacion mbi procedurën e mësipërme të prokurimit si dhe aktin e trajtimit të ankesës të operatorit ekonomik “Gentian Sadiku” PF, ku konstatohet se ankesa e këtij të fundit është refuzuar.

II.7. Gjithashtu, nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, si dhe bazuar në informacionin e autoritetit kontraktor, u konstatua se nuk ka pasur pretendime nga subjekte të tjera të interesuara, në përputhje me nenin 113 ligji Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

### III

#### **Komisioni i Prokurimit Publik**

pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur tyre,

#### **Arsyeton**

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Armand Sinani” PF se arsyeja e skualifikimit të ofertës së tij ekonomike “[...]Në rastin konkret për përmbushjen e këtij kriteri



operatori ekonomik “Armand Sinani” PF ka dorëzuar në sistemin e prokurimeve elektronike “Deklaratë” sipas formatit të përcaktuar në DST bazuar në të cilën deklarojmë se shfaqemi në cilësinë e prodhuesit të mallrave objekt prokurimi si dhe një informacion shtesë duke dorëzuar “Deklaratë për lëndën e parë” duke specifikuar kompaninë me të cilën bashkëpunojmë në furnizimin me lëndën e parë, të shoqëruar me akt marrëveshjen me këtë shoqëri, në mënyrë të tillë që të krijojmë një panoramë më të qartë si dhe të garantojmë autoritetin kontraktor për furnizimin me mallrat objekt prokurimi sipas sasisë dhe cilësisë së kërkuar.

[...]Së pari, gjykojmë se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë vetëm kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa. Në rastin konkret bazuar në legjislacionin “Për prokurimin publik” si dhe në dokumentet standarde të tenderit, vlerësojmë se kriteri i mësipërm për kualifikim përmbushet vetëm nëpërmjet dorëzimit nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës të deklaratës sipas formatit të përcaktuar në DST, bazuar në të cilën operatorët ekonomikë ndër të tjera deklarojnë nëse janë në cilësinë e prodhuesit apo distributorit të mallrave objekt prokurimi. Gjithashtu bazuar në frymën e legjislacionit për prokurimin publik” gjykojmë se autoriteti kontraktor gjatë procesit të verifikimit mbi vërtetësinë e deklaratave të dorëzuara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të veprojë në të njëjtën linjë si e verifikimin e informacioneve të deklaruara nëpërmjet “Formularit Permbledhës të vetëdeklarimit”, pra në gjykimin tonë autoriteti kontraktor duhet të kërkojë informacione dhe sqarime përpara kryerjes së vlerësimit dhe në rastin konkret AK nuk ka kërkuar asnjë sqarim apo informacion në lidhje me deklaratën e dorëzuar në SPE nga operatori ekonomik “Armand Sinani” PF.

Në gjykimin tonë ka dy mënyra se si autoriteti kontraktor mund të kryejë verifikimet mbi deklaratat e operatorëve ekonomikë, e para në bazë të të dhënave të aksesueshme shtetërore nëse këto të dhëna janë të disponueshme dhe e dyta “duke I kërkuar operatorit ekonomik pjesëmarrës dokumentet dhe sqarime të tjera shtesë që vërtetojnë deklaratat e dorëzuara.

[...] Përsa i përket pretendimit se operatori ekonomik “Armand Sinani” PF nuk shfaqet në cilësinë e prodhuesit të mallrave objekt prokurimi pasi nga shqyrtimi i të dhënave në QKB rezulton se ky operator ekonomik nuk ka fabrikë për prodhimin e këpucëve por disponon vetëm një zyrë për aktivitetin e subjektit, kërkojmë të sqarojmë se operatorët ekonomikë nuk kanë detyrimin ligjor të regjistrohen në QKB me adresë të ndryshme që shërben si zyrë të aktivitetit dhe me adresë të ndryshme që shërben për prodhimin apo magazinimin e mallrave. Në rastin konkret kërkojmë të sqarojmë se “Armand Sinani” PF në adresën e specifikuar në QKB ka jo vetëm zyrat e aktivitetit por gjithashtu edhe ambiente që shërbejnë për kryerjen e proceseve të ndryshme të prodhimit të mallrave objekt prokurimi si dhe ambiente që shërbejnë për magazinimin e këtyre mallrave. Përsa i përket pretendimit se operatori ekonomik “Armand Sinani” PF nuk shfaqet në cilësinë e prodhuesit të mallrave objekt prokurimi pasi referuar pasqyrave financiare të vitit të fundit të aktivitetit të 2022, zëri impinate dhe makineri nuk ka të dhëna mbi disponimin e një kapaciteti prodhues që do të mundësonte OE të realizonte objektin e prokurimit prodhimin e këpucëve [...].

[...]Në lidhje me sa më sipër së pari kërkojmë të theksojmë se operatori ekonomik “Armand Sinani” PF e ka të regjistruar në QKB ndër të tjera edhe aktivitetin e prodhimit të këpucëve duke e ushtruar këtë aktivitet në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.

Së dyti, kërkojmë të sqarojmë më në detaje mënyrën e kryerjes së procesit të prodhimit të mallrave objekt prokurimi nga operatori ekonomik “Armand Sinani” PF.

Kërkojmë të sqarojmë se ndër vite operatori ekonomik “Armand Sinani” PF kryen një pjesë të procesit të prodhimit (injektimin e gomës) të mallrave objekt prokurimi në shtetin Italian në bashkëpunim me {\*\*\*} srl bazuar në kontratën mes palëve të datës 22/05/2023, ndërsa pjesën tjetër të procesit të prodhimit operatori ekonomik “Armand Sinani” P.F e kryen në autonomi në ambientet dhe me mjetet e tij.

Në lidhje me procesin e prodhimit që kryen në shtetin Italian në bashkëpunim me {\*\*\*} srl kërkojmë të sqarojmë se, shoqëria italiane {\*\*\*} Srl kryen këtë process të punës në emër dhe për llogari të “Armand Sinani” PF duke përdorur lëndët e para të kërkuara apo që dërgohen nga ana e “Armand Sinani” PF.

[...] Gjithashtu në lidhje me pretendimin e autoritetit kontraktor se referuar pasqyrave financirae të vitit të fundit të aktivitetit 2022, zëri impiante dhe makineri nuk ka të dhëna mbi disponimin e një kapaciteti prodhues që do ti mundësonte OE të realizonte objektin e prokurimit kërkojmë të sqarojmë se operatori ekonomik “Armand Sinani” PF proceset e tjera të prodhimit si dhe paketimin dhe magazinimin e produkteve objekt prokurimi i kryen me mjetet e veta në amjentet e tij[...].

[...] Akoma me tej thksojmë se produkti përfundimtar jo vetëm që prodhohet, paktohet dhe magazinohet nga operatori ekonomik “Armand Sinani” PF por në të njëjtën kohë theksojmë se këto mallra dalin në treg në emër të operatorit ekonomik “Armand Sinani” PF dhe ky produkt mban etiketën dhe të dhënat e “AR-EN” që është emri tregtar i “Armand Sinani PF,” Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 9 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.3.6 “Kapaciteti teknik” në dokumentet e tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

1. Operatori ekonomik ne lidhje me artikujt objekt prokurimi te percaktuar shtojcën 6 Formulari i sasisë dhe Grafiku i ekzekutimi, qe do te paraqese, duhet te plotësoje tabelën e mëposhtme duke specifikuar vendin e origjinës si dhe certifikimet te leshuara nga nje organ i akredituar/autorizuar.

<b>Nr.</b>	<b>Emertimi i produktit</b>	<b>Vendi i origjinës</b>	<b>Prodhues/Distributor</b>	<b>Certifikatë konformiteti ose cilësie CE (kur është e aplikueshme)/ekuivalent</b>
<b>1</b>				
<b>2</b>				
<b>Etj.,</b>				

**Shënim 6.1:**

Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin prane AK certifikatat e cdo produkti.

**Të dhënat që do të deklarohen, detyrimisht do të paraqiten Autoritetit Kontraktor për të genë pjesë e planit të zbatimit të kontratës. Rastet e deklaratave te rreme, do të**

**konsiderohen kushte për skualifikim, si dhe do të ndiqet procedura per perjashtim nga Agjencia e Prokurimit Publik.**

III.1.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se operatori ekonomik “Armand Sinani” PF, në përmbushje të kriterit sa më sipër, ka dorëzuar:

- Dokumentin pdf “Deklaratë” në të cilën deklaron se shfaqen në cilësinë e prodhuesit të mallrave objekt-prokurimi.
- Dokumentin pdf “Deklaratë për lëndën e parë” duke specifikuar kompaninë me të cilën bashkëpunon për furnizimin me lëndë të parë.

III.1.3. Në nenin 77 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se:

*“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

*Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.*

*2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.*

*Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.*

*3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.*

*Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.*

*Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.*

*Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve,*

duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

Në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”.

III.1.4. Në nenin 40, pika 5 e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “5. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

- a) licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose
- b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose
- c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose
- ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit

III.1.5. Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me

sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 *“Për prokurimin publik”*. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato.

Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës. Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimit elektronik, nga operatori ekonomik “Armand Sinani” PF, konstatohet, se ky i fundit në përmbushje të kriterëve të veçanta për kualifikim, pikës 2.3.6, ka dorëzuar Dokumentin pdf “Deklaratë” në të cilën deklaron se shfaqen në cilësinë e prodhuesit të mallrave objekt-prokurimi, si dhe Dokumentin pdf “Deklaratë për lëndën e parë”, duke specifikuar kompaninë me të cilën bashkëpunon për furnizimin me lëndë të parë. Bazuar në deklaratën e dorëzuar në përmbushje të kriterit të sipërpërmendur, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se është me vend të theksojë rolin e posaçëm që ka autoriteti kontraktor, për vetëcilësimin e tij ligjor, si autoriteti me interes dhe përgjegjësi thelbësore për realizimin e suksesshëm të kontratës. KPP sjell në vëmendje, se referuar rregullave të prokurimit publik dhe dokumenteve të tenderit, është pikërisht autoriteti kontraktor ai që duhet të bëjë verifikimet dhe mund të kërkonte sqarime nëse kishte dyshime lidhur me faktin nëse operatori ekonomik ishte prodhues i mallit objekt-prokurimi.

Komisioni i Prokurimit Publik shkon akoma më tej dhe gjykon, se për autoritetin kontraktor e rëndësishme është që operatorët ekonomikë të vërtetojnë që janë prodhues të produktit përfundimtar. Në dokumentacionin e dorëzuar pranë KPP operatori ekonomik ka dorëzuar edhe kontratën e prodhimit datë 22.05.2023 që ka me kompaninë {\*\*\*} S.r.l sipas të cilës kompania {\*\*\*} Srl deklaron se vendos kompaninë e vet në dispozicion ekskluziv të nevojave të prodhimit të kompanisë “Armand Sinani” PF. Komisioni gjykon, se kjo mënyrë disponimi nuk bie në kundërshtim me asnjë akt ligjor apo nënligjor në fuqi, si dhe përmbush kriterin e vendosur nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit të procedurës së prokurimit objekt-shqyrtimi.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.2 Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Armand Sinani” PF, se arsyeja e skualifikimit të ofertës së tij ekonomike “[...] Sqarojmë se kemi dorëzuar në SPE si dhe fizikisht në momentin e dorëzimit të mostrave fletë analizat laboratorike me numër A2-2H, L2-35, L2-39, L2-40, L2-42, A2-41, L2-34, L2-33, L2-38, L2-36, L2-37, të realizuara pranë “Laboratorit Fiziko Mekanik dhe Kimik i Tekstilit dhe Lëkurës” pranë “Universitetit Politeknik të Tiranës”. Në lidhje me fletë analizat e mësipërme fillimisht kërkojmë të theksojmë se “Laboratori Fiziko Mekanik dhe Kimik i Tekstilit dhe Lëkurës” pranë “Universitetit Politeknik të Tiranës” është një laborator i akredituar nga Drejtoria e Akreditimit, madje nga verifikimet e kryera rezulton se është i vetmi laborator i akredituar në territorin tonë për kryerjen e këtyre testeve dhe rrjedhimisht përmbush kushtin që raport analizat të kryhen në një laborator të akredituar.

Gjithashtu pasi morëm në shqyrtim shtojcën 7 “Specifikimet Teknike” si dhe fletë analizat laboratorike të dorëzuara nga operatori ekonomik “Armand Sinani” PF konstatojmë se të dhënat dhe specifikimet teknike për komponentët që kryhen nga ky laborator janë në përputhje të plotë me specifikimet teknike të kërkuara në dokumentet standarde të tenderit dhe rrjedhimisht gjucojmë se operatori ekonomik “Armand Sinani” PF e përmbush plotësisht këtë kriter.

Së dyti, duke marrë në konsideratë parashikimin në dokumentet standarde të tenderit bazuar në të cilin “kolaudimi i mallrave objekt prokurimi do të kryhet mbi bazën e rezultateve të fletë analizave laboratorike të lëshuara nga laboratorë të akredituar të lëkurë-këpucës, që shoqërojnë mallin, të sjella nga kontraktuesi, sipas përcaktimeve në kontratë dhe ekzaminimit e testimit të mallit të furnizuar, që do të kryejë komisioni i pritjes, kontrollit dhe pranimin të Gardës së republikës, pranë laboratorëve të akredituar, duke i krahasuar rezultatet e tyre me rezultatet e analizave të sjella nga OE furnizues”, gjucojmë se në rastin konkret duke qenë se autoriteti kontraktor ka kërkuar edhe dorëzimin e mostrave për mallrat objekt prokurimi, në rast se autoriteti kontraktor ka dyshime të arsyeshme për mospërmbushjen e specifikimeve teknike të kërkuara mund të kryejë raport testimet përkatëse në mënyrë të tillë që Ak të garantohet për përmbushjen e këtyre specifikimeve. [...]” Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.2.1. Në shtojcën 9 “Kriteret e veçanta për kualifikim” pika 2.3.8 të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet si vijon:

8. Operatori ekonomik, ditën e hapjes së dokumentacionit ne fazen e pare, duhet të depozitojë pranë Agjencisë Shtetërore të Prokurimeve të Përqëndruara, mostrat e artikujve sipas tabelës 1,
  - mostrat duhet të kenë të trupezuar vulën dhe etiketen orgjinale të fabrikes prodhuese;
  - cope të lëndës së parë me permasa 30 x 30 cm, me vulë dhe etikete orgjinale të ofertuesit,;
  - Lloji i mostres, lëndës së parë dhe ajo që i bashkëngjitet raport-analizes duhet të jenë detyrimisht të njëjta;

- Fletë analize laboratorike të cilat duhet të jenë të realizuara nga laboratorë të akredituar sipas akreditimeve kombëtare dhe/ose ndërkombëtare. Këto testime duhet të jenë në përputhje të plotë me specifikimet teknike. Në rast se testimet do të jenë realizuar nga laboratorë të ndërkombëtar të paraqiten të dhënat si më poshtë për laboratorët:

Nr.	Emri I laboratorit	Institucioni akreditues	Të dhëna kontakti të laboratorit( nr. tel, email)
1			
2			
3			
4			
etj			

Tabela nr. 1

Nr.	Emërtimi i Objektivit të Uniformës	Njësia	Sasia
1	Këpucë me qafa sherbimi e stervitje	palë	1
2	Këpucë me qafa dimri	palë	1
3	Këpucë gjysma uniforme	palë	1

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**

**Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

III.2.2 Në shtojcën 7 “Specifikimet Teknike” të dokumenteve të procedurës së prokurimit përcaktohet si më poshtë vijon:

### SPECIFIKIME - TEKNIKE

#### **OBJEKTI : “Këpucë gjysma uniforme” për punonjësit e Gardës së Republikës**

Ky specifikim teknik në mënyrë të detajuar paraqet kerkesat themelore teknike të domosdoshme për prodhimin e artikullit “Këpucë gjysma uniforme“. Në këtë specifikim teknik përcaktohen gjithashtu dhe kerkesat teknike të aksesoreve që shoqërojnë artikullin “Këpucë gjysma uniforme ” si produkt i gatshëm .

**Të gjitha përcaktimet teknike të këtij specifikimi teknik duhen të zbatohen detyrimisht saktë nga prodhuesi.**

*Për procedurë vlerësimi dhe miratimi nga përdoruesi, ofertuesi është i detyruar të paraqesë si ofertë teknike të realizuar sipas kërkesave të këtij specifikimi teknik:*

**a.** *1(një ) palë këpucë Nr. 42.*

*mostra duhet të ketë të trupezuar vulen dhe etiketen orgjinale të fabrikes prodhuese.*

**b.** *1 (një ) copë lekurë natyrale boks vici me permasa 30 x 30 cm, me vulë dhe etikete orgjinale të ofertuesit, të trupëzuar.*

**c.** *1(një) cope astar meshini dhie, me permasa 30 x 30 cm me vulë dhe etikete orgjinale të ofertuesit të trupëzuar.*

**d.** *Fletë-analize laboratorike të treguesve fiziko–mekanik e kimik të lëndës së parë lekurë natyrale boks vici dhe astarit meshin dhie.*

*Lekura e mostres, lëndës së parë dhe ajo që i bashkëngjitet raport-analizës duhet të jenë detyrimisht të njejta.*

**Mungesa e mostres, lëndës parë dhe fletë analizës që shoqeron ato është kusht skualifikues.**

#### **LËNDËT E PARA E NDIHMËSE :**

##### **A. Pjesa e sipërme.**

- *Lekurë natyrale (boks) viçi, cilësia e parë: sipas (STASH.1143-89)*
  - ngjyra *e zeze*
  - cngjyrosja *> nota 4*
  - trashësia *1.1 – 1.4 mm*
  - yndyra *4 -7 %*
  - rezistenca ndaj plasjes së faqes *> 1.8 kG/mm<sup>2</sup>*
  - rezistenca ndaj keputjes së faqes *> 2.0 kG/mm<sup>2</sup>*
  - zgjatimi në ngarkese *15 – 25 %*
  - qendrueshmëria deri në këputje *40 – 60 %*
  - penetrimi i ujit gjendje statike *> 40 minuta*
  - rregjia *0 % rregjia shumë e mirë*
- *Meshine dhie – cilesia e pare per astarin e faqes, lapetes, mbrapshtines dhe shtrojtes me trashesi 0.9 – 1.2 mm. (STASH -1144-89)*
  - yndyra *4 -7 %*
  - rezistenca ndaj plasjes së faqes *> 1.3 kG/mm<sup>2</sup>*
  - rezistenca ndaj keputjes së faqes *> 1.5 kG/mm<sup>2</sup>*
  - zgjatimi në ngarkesë *15 – 30 %*
  - rregjia *0 % rregjia shume e mire*
- *Suprina është një copshe, këpuca përpara vjen me maje jo shumë të theksuar.*
- *Penje-Sintetike me fortësi 38 kg(4hapa ne 3 cm) per qepjen brenda jashte të fjapes me tabanin,*  
*penj sintetike me ngjyrë të zezë me reziztence mbi 9 kg Nr 40/3 për masuren dhe 30/3 për qepjen e suprines (veshet,mbrapshtines, filetove dhe tegelave të tjere të faqes së këpucës).*
- *Bombe material termoplastik me trashesi jo me pak se 1 mm.*



- Forte material termoplastik me trashesi jo me pak se 1 mm .

***B:Pjesa e poshtme.***

- Sholle gome kompakte e presuar (pjesa e poshtme e kepuces) me trashesi 9–10 mm nga e cila 2+/-0.5 mm te jete trashesia e kanaleve ose e luleve (reliev kunder rreshqitjes).
- Taban– Solete (lekure natyrale) me trashesi 3+/-05 mm.
- Fjap gome e presuar me trashesi 3+/-05 mm.
- Xhiro gome e presuar me pjerresi konike e gjeresi 17-19 mm.
- Taka gome e presuar me lartesi 2.8 –3 cm (se bashku me gomen e fjapen qe shoqerohet me xhiro)
- Ngjites 1 komponent per ngjitjen e fjapes me tabanin dhe ngjites 2 komponente per ngjitjen e fjapes me shollen.Ngjitja te jete shume e mire.

***Treguesit cilesore te pjeses se poshteme :***

- Fortesia ne grade shore per “Shoje te presuar” te jete 73+/-3
- Fortesia ne grade shore per “Fiap te presuar” te jete 80+/-5.

- **PERPUNIMI PERGATITOR**

**Kolaudimi i lendes se pare dhe materialeve ndihmese**

Kolaudimi i lendes se pare dhe materialeve ndihmese ne menyre te sakte dhe te drejte eshte baze per nje ecuri cilesore te procesve teknologjike te metejshme zinxhir per prodhimin me cilesi te artikullit “Këpucë gjysma uniforme”.

**Prerja**

Procesi i prerjes kryhet me tranxhe me ane te formave te pergatitura dhe duhet te behet me shume kujdes per nje shfrytezim sa me optimal te materialit qe pritet.Buzet e detajeve te prera duhet te jene te pastra sidomos ne pjeset e harkuara.Prerjes me tranxhe sipas formave iu nenshtrohet lekura boks vici, astari i meshinit,bombes dhe fortit termoplastik,kartonit dhe tabanit prej soleti lekure.

**Pergatitja me presim e fiapes dhe e sholles**

Ne kete proces prodhohet fiapa dhe sholla me ane te presimit ne te nxehte te materialit granul. Xhiroja eshte e presuar se bashku me fiapen ne nje trup te vetem ne menyre uniforme pergjate gjithë buzeve te saj. Taka e kepuces presohet se bashku me shollen.Taka nga poshte eshte me relief dhe se bashku me shollen ka lartesi **22-23 mm**.Gjate ketij procesi duhet bere shume kujdes qe fiapa dhe sholla nuk duhet te kene rrjedhje nga procesi i vullkanizimit,diference ne trashesi, gropa, gunga, siperfaqe jo te lemuar dhe lulezim te squfurit.

**Procesi i prodhimit**

*Procesi i prodhimit te kepuces ndahet ne dy faza kryesore.*

**Faza e pare** eshte pergatitja e pjeses se siperme te kepuces gjate te ciles realizohet bashkimi dhe qepja e pjeseve perberese prej lekure boks vici te kepuces se bashku me astarin e meshinit, fiksimi i bombes dhe fortes termoplastike si dhe fiksimi i kamaretes se celikut tek tabani prej soleti.

**Faza e dyte** realizon dhenien e formes se pjeses se poshtme te kepuces me ane te presimit ne kallep, fiksimin e tabanit si dhe montimin e fjapes dhe te sholles, punimet perfundimtare dhe lyerjen me boje. Midis proceseve te ndermjetme te kesaj faze per nje perpunim sa me te mire ne perputhje me kerkesat teknologjike gjysemprodukti kalon dhe i nenshtrohet dhe proceseve termike ne furren e ngrohjes.

**Ne fazen e pare:** pjeset e prera te lekures bashkohen me njera tjetren me ane te procesit te qepjes. Faqja (pjesa e perparme) eshte me trashesi 1.1-1.4 mm. Gjeresia e pjeses se mbyllur te faqes me pjesen e perparme duhet te jete e pergatitur ne menyre te tille qe mundesoje nje zmerilim dhe barazim sa me te mire. Gjeresia e pjeses qe mbyllet ne anen e jashtme tek veshet (pjesa e siperme e mbrapme) duhet te jete deri ne 1 mm. Tegeli me hap 6-8 hapa ne 1 cm duhet te jete 1 mm larg buzeve. Fileta qepet mbrapa ne te dy anet e saj me tegel 1 mm larg buzeve. Lapeta me trashesi 1-1.2 mm fiksohet me tegel nga pjesa e perparme e faqes dhe astarit te saj.

Astari meshin dhie duhet te vendoset ne te gjitha siperfaqen e brendeshme te kepuces si dhe tek lapeta. Fodera e faqes (pjesa e perparme ndermjetese) me trashesi 0.9 mm fiksohet me faqen si me ngjitje ashtu dhe me qepje. Fodera e veshit (pjesa e mbrapme ndermjetese) me trashesi 0.9 mm e fiksuar me mbrapshtinen me ngjitje duke u kapur njekohesisht me tegelin e mbylljes gjate qepjes se mbrapshtinave dhe te filetes. Astari faqes (pjesa e brendshme e perparme) me trashesi 0.9-1.1 mm kapet me qepje me pjesen e perparme te faqes se bashku me lapeten. Astaret shtroje me trashesi 0.9-1.2 mm vendosen me ngjitje.

Gjate procesit te qepjes te pjeseve te lekures me astarin kryhet njekohesisht dhe procesi i fiksimit te bombes termoplastike dhe fortit termoplastik. Bombeja vendoset me ngjitje tek maja e kepuces midis pjese se siperme dhe te poshtme ne largesi 6-8 mm nga buzet e faqes se pjeses se siperme. Forti vendoset me ngjitje tek pjesa e mbrapme e kepuces midis pjese se jashtme dhe te brendeshme ne largesi 10 mm nga buza e filetos nen pjesen e mbrapme.

Tegelat e qepjes tek faqja, mbrapshtinave, fileta dhe siperines se vesheve realizohen me pe me Nm 40/3 dhe Nm 30/3. Tegelat duhet te jene 1-2 mm larg buzeve dhe me hap 3-4 hapa ne 1 cm. Mbyllja e faqes relizohet me makine dygjilpershe ku distanca ndermjet tegelave paralel duhet te jete 3-4 mm. Per te realizuar nje perforcim sa me te forte gjate mbylljes se siperines tegelat qepen dyfish. Tegelat duhet te jene te rregullt, te forte, pa vende te shqepura dhe te perforcuar ne fund.

Tabani prej soleti lekure duhet te jete i barazuar dhe i zmeriluar ne te dy anet. Tabanit nga poshte duke filluar qe nga pjesa e rrumbullaket te fundi i thembres i fiksohet kamareta. Kamareta ne te gjitha gjatesin e saj duhet te mbulohet me karton fiber te presuar me gjatesi 14-15 cm dhe gjeresi 6.4- 6.6 cm.

**Ne fazen e dyte:** gjysemprodukti i perfunduar (pjesa e siperme e kepuces) kalon ne procesin e dhenies se formes se kepuces me ane te fiksimit neper kallep te gatshem. Gjate ketij procesi behet njekohesisht dhe vendosja e tabanit ne menyre te tille qe kamareta te perputhet

plotesisht me boshllekun qe krijohet nga trashesia e faqes.Gjysemprodukti i nenshtrohet procesit te zmerilimit dhe barazimit te pjeses se poshtme gjate te cilit duhet bere kujdes qe te eliminohen te gjitha palat,kanalet ose te ngriturat sidomos ne maje,ne thember dhe ne pjesen qendrore te jashtme dhe te brendshme te tij duke bere nje barazim sa me te mire te siperfaqes se pjeseve te kthyera te lekures.Zmerilimi dhe barazimi shume i mire ben te mundur realizimin me cilesi te larte te procesit te fiksimit te fiapes me tabanin.

**Fiapa** fiksohet me tabanin dhe pjesen e poshtme te gjysemproduktit me ngjitje dhe me qepje.Per ngjitjen perdoret material ngjites me nje komponent.Materiali ngjites duhet te perhapet si ne te gjitha siperfaqen e siperme te fiapes ashtu dhe ne te gjitha siperfaqen e pjeses se poshtme te gjysemproduktit. Ngjitja duhet te kryhet ne te gjitha siperfaqen e fiapes dhe pjeses se poshtme te gjysemproduktit.Ngjitja duhet te jete shume e mire.Rezistenca e ngjitjes se fiapes me tabanin duhet te jete e larte.Qepja e fiapes me tabanin behet brenda dhe jashte dhe kryhet me makine.Per qepje perdoret pe sintetik me fortesi 38 kG me hap te tegelit 4 hapa ne 3 cm.Tegeli duhet te jete shume i forte dhe nuk duhet te dali jashte buzeve te fiapes ose te tabanit.Kanali i fiapes duhet te jete me gjeresi 2 mm dhe thellesi 1.5 mm. Distanca nga kendi i prerjes se fiapes ne mesin e kanalit duhet te jete 10-12 mm.

**Sholla** fiksohet me fiapen me ngjitje duke perdorur material ngjites me dy komponente.Materiali ngjites duhet te perhapet si ne te gjitha siperfaqen e poshtme te fiapes ashtu dhe ne te gjitha siperfaqen e pjeses se siperme te sholles.Ngjitja duhet te kryhet ne te gjitha siperfaqen e sholles dhe fiapes dhe te jete shume e mire.Rezistenca e ngjitjes se fiapes me tabanin duhet te jete mbi 20 N.

Ne brendesi te kepuces siper te gjitha siperfaqes se tabanit me ngjitje dhe e shtrire mire vendoset si shtroje astar meshini me trashesi **0.9-1.2mm**.Midis asatrit dhe tabanit ne qender te pjeses ku vendoset dhe qendron shputa e kembes duhet te jete fiksuar me ngjitje material i bute (sfungjer i presuar). Ne perfundim behet zmerilimi dhe barazimi i buzeve te bashkimit te fiapes me shollen,perpunimet perfundimtare te rifinitures dhe lyerja me boje.



*(për meshkuj)*



*(për femra)*

### **KLASIFIKIMI**

*a. Numrat e kepuceve do të jënë sipas Nr 39 deri 46.*

*Sasia sipas numerave do të behet mbi bazen e kerkesave të Gardes me lidhjen e kontrates me prodhuesin.*

*b. Kepucet prodhohen me 2 fraksione me gjatesi dhe gjeresi të ndryshme sipas numrave. Permasat e meposteme i referohen kepuces Nr.41.*

#### **Fraksioni i I-re**

*gjatesia*                      273 mm  
*gjeresia*                      245 mm

#### **Fraksioni i II-te**

275 mm  
255 mm

*Toleranca për gjatesine është 6.67 mm dhe vlen për të gjitha gjatesite.*

*Lartesia e qafes së kepuces e matur nga jashtë mbi xhiron e gomes duke iu referuar numrit 41 duhet të jetë :                       $41 + 24 = 65 \text{ mm} \pm 1 \text{ mm}$ .*

*Lartesia e qafes së kepuces e matur nga brenda mbi astarin e shtrojes duke iu referuar numrit 41 duhet të jetë :                       $41 + 17 = 58 \text{ mm} \pm 1 \text{ mm}$ .*

*Koeficientet 24 mm dhe 17 mm vlejne për të gjithë numrat e kepuceve.*

***Amballazhimi, marketimi dhe etiketimi.***

*Kepucet të jënë të ambllazhuara në kuti kartoni 1 (një) pale në çdo kuti.*

*Çdo kuti nga ana e jashtme te kete numrin e kepuceve.*

*Artikulli “Këpucë gjysma uniforme” marketohet ne ane ne astarin e brendshem afer fundit te lartesisë se qafes ku shenohet qarte numri i kepuces. Numri i kepuces duhet te jete i shenuar ne menyre te dukshme dhe poshte sholles se gomes.*

**Garancia.** *Garancia e kepuceve ne perdorim te jete 1 vit. Furnizuesi merr persiper zevendesimin e kepuceve te demtuara gjate perdorimit brenda afatit te garancise, si dhe per difekte qe vijne si rrjedhoje e procesit teknologjik.*

**Afati i lëvrimit:** *Brenda 90 ditëve nga lidhja e kontratës, por jo më vonë se data 20 dhjetor i vitit planifikues.*

### **Kolaudimi, marrja në dorzim**

*Pranimi i të gjithë sasisë të artikullit “Këpucë gjysma uniforme” të përcaktuar në kontratë dhe të dorëzuar në magazinën e Gardës, do të bëhet vetëm në bazë të rezultateve që do të merrën gjatë procesit të Kolaudit për të gjithë sasinë e produktit të gatshëm të dorëzuar në magazinë. Kolaudimi do të bëhet mbi bazën e rezultateve të Fletë-analizave laboratorike të lëshuara nga Laboratore te Akredituar te Lëkurë – Këpucës, që shoqërojnë mallin, të sjella nga kontraktuesi, sipas përcaktimeve në kontratë, dhe ekzaminimit e testimi të mallit të furnizuar, që do të bëjë Komisioni i pritjes, kontrollit dhe pranimi të mallit të Gardës së Republikës, pranë laboratorëve të akredituar, duke i krahasuar rezultatet e tyre me rezultatet e analizave të sjella nga OE furnizues”. Gjithashtu, komisioni kryen direkt matjet dhe provat fizike të sasisë së mallit të dorëzuar dhe bën krahasimin e të gjithë këtyre rezultateve me kerkesat dhe të dhënat teknike të këtij specifikimi teknik, kampionit të ofruar dhe modelit të miratuar.*

**Artikulli konsiderohet teknikisht i pranuar kur ai ploteson të gjitha kerkesat e këtij Specifikimi Teknik.**

## **SPECIFIKIME - TEKNIKE**

**OBJEKTI :** **“Këpucë me qafa dimërore” për punonjësit e Gardës së Republikës**

*Ky specifikim teknik në mënyrë të detajuar paraqet kerkesat themelore teknike të domosdoshme të artikullit “Këpucë me qafa dimërore”.*

*Në këtë specifikim teknik percaktohen gjithashtu dhe kerkesat teknike të aksesoreve që shoqërojnë artikullin “Këpucë me qafa dimërore” si produkt të gatshëm .*

**Të gjitha përcaktimet teknike të këtij specifikimi teknik duhen të zbatohen detyrimisht saktë nga prodhuesi.**

*Për procedure vleresimi dhe miratimi nga perdorusi, ofertuesi është i detyruar të paraqese si ofertë teknike të realizuar sipas kerkesave të këtij specifikimi teknik:*

- a. 1(një ) palë këpucë Nr 42, mostra duhet të ketë të trupezuar vulen dhe etiketen orgjinale të fabrikes prodhuese.*
- b. 1 (një ) copë lekurë natyrale lëkurë viçi (boks) cilësia e parë me permasa 30 x 30 cm, me vulë dhe etiketë orgjinale të ofertuesit, të trupezuar.*
- c. 1(një) copë astar meshini dhie, me permasa 30 x 30 cm me vulë dhe etiketë orgjinale të ofertuesit të trupezuar.*
- d. Fletë-analize laboratorike të treguesve fiziko–mekanik e kimik të lëndës së parë, lëkurë viçi (boks) cilësia e pare dhe astarit meshin dhie.*

*Lekura e mostres, lëndës së parë dhe ajo që i bashkengjitet raport-analizes duhet të jenë detyrimisht të njëjta.*

*Mungesa e mostres, lëndës parë dhe fletë - analizës që shoqeron ato është kusht skualifikues.*

- **KARAKTERISTIKA TE PERGJITHESHME:**

*a. Materialët bazë që duhet të përdoren për prodhimin e artikullit “këpucë me qafa dimërore” duhet të jetë i cilësisë së parë me këto të dhëna teknike:*

- **FAQET DHE FILETA:** lëkurë viçi (boks) cilësia e parë

*Ngjyra: faqet dhe fileta e zezë, e njëtrajtshme, me pak shkëlqim*

*Trashësia: faqet dhe fileta 1.4-1.6 mm*

- **ASTARI:** meshin dhie cilësia e parë me trashësi 0.6-0.9 mm për veshjen pjesëve të lëkurës, 0.9-1.2 mm për mbulimin e shollës së brendshme.

*Regjja: kromike*

*Mënyra e përpunimit: Me faqe natyrore*

*Lagështira: faqet dhe fileta 16-18%, astari 16%*

*Hiri: faqet dhe fileta 4-5%, astari 4-6%*

*Yndyra: faqet dhe fileta 4-7%, astari 4-6%*

*Prania e oksidit të kromit: faqet dhe fileta > 3.5%, astari 3%*

*Rezistenca ndaj plasjes: faqet dhe fileta jo më pak se 1.8/10 MPa, astari jo më pak se 0.8/10 MPa.*

*Qëndrueshmëria deri në këputje: faqet dhe fileta 40 – 60 %*

*Penetrimi i ujit në gjëndje statike: faqet dhe fileta jo më pak se 40 minute.*

*Plasja e faqes në palosje katërshe: Nuk lejohet*

- **SHOLLA:** gomë e presuar me reliev kundër rrëshqitjes

*Ngjyra: e zezë*

*Lartësia: 7-8 mm tek maja, rreth 38 mm tek taka*

*Rezistenca në këputje: jo më pak se 17 MPa*

*Konsumi: jo më shumë se 150 mm<sup>3</sup>*

*Fortësia: 750 Shore ±3*

*Masa vëllimore: 1.2 g/cm<sup>3</sup>*

**Shënim.**

*Kërkesat e lëndës së parë për lëkurë natyrale i cilësisë së parë janë bazuar tek Standardi Shqiptar (SSH) 1143 : 1990, “Lëkurë kromike për suprina këpucësh”.*

*Kërkesat e lëndës së parë meshin dhije i cilësisë së parë janë bazuar tek Standardi Shqiptar (SSH) 1144: 1990, “Meshinat”.*

*Kërkesat e lëndës së parë të brumit që përdoret për prodhimin e shojeve të presuara tip “U”, i cilësisë së parë janë bazuar tek Standardi Shqiptar (SSH) 2638 : 1989 “Shoje të presuara tip U”.*

**b. Materialet ndihmëse dhe aksesoret që duhet të përdoren për ndërtimin e artikullit këpucë me qafa dimërore:**

**MATERIALET PËR SHTROJËN:**

**Karton kompakt i presuar:** Me përbërje Celulozë, trashësia 1.9-2 mm

**Karton fibër i presuar:** Me përmasa 14 - 15 cm, gjerësia 6.4-6.5 cm, forma sipas tabanit.

**Material për pjesën e shtrojës:** Sfungjer i hollë (memory foam), me përmasa 4 - 6 mm.

**Kamaretë metalike:** Shirit çeliku i kanalizuar me nervaturë, me përmasa 14 - 15 cm, me gjerësi 8 – 10 mm.

**PËRFORCUES:**

Material termoplastik (forti) që nuk thyhet: Trashësia 1.4mm±0.1mm

Material termoplastik (bombeja) që nuk thyhet: Trashësia 1.2mm±0.1mm

Material përforcues për pjesën e vrimave tek veshët

**LIDHËSET:**

Lidhëse tubolare me ekstremitete plastike: Ngjyra e zezë

Thurrja: gërshet (që nuk shthuren),

Përbërja: 100% poliester

Gjatësia: rreth 90 cm.

**FIJET:**

Fill për qepjen e lëkurës: 100 % polyester

Qendrueshmëria: mbi 9 kg

Hollësi: për faqet e këpucës Nm 30/3 tex, për astar Nm 40/3 tex,

Ngjyra: në tonalitet me këpucën

**Syza për vrimat e lidhëseve:** Metalike me diametr 7 mm.

**Solucion lyerje kundra ujit për fortin dhe bombenë.**

**Ngjitësi:** Ngjitësi që do të përdoret duhet të jetë me një dhe dy komponent (me një komponent krijon mbylljen e poreve të dala nga guri zmeril, komponenti i dytë me një lloj tjetri mastiçi që me anën e nxehtësisë krijon ngjitjen me anë të forcës me makineri presimi). Ngjitja me tabanin dhe me faqen e qepur përbëhet nga dy komponentë të mastiçit. Në këtë mënyrë krijohet një ngjitje shumë cilësore, rezistente në mosshqitje, për aq kohë që janë në përdorim këpucët.

## • **PËRPUNIMI DHE PËRGATITJA E MATERIALEVE BAZË**

*Përgatitja e lëndës së parë dhe materialeve ndihmëse në mënyrë të saktë dhe të drejtë është bazë për një ecuri cilësore të proceseve teknologjike të mëtejshme gjatë prodhimit me cilësi të këpucë me qafa dimërore*

### **Modelimi (ndërtimi i kallëpeve)**

*Ky proces duhet të realizohet me metoda matematikore të ndërtimit të kallëpeve. Pjesët përbërëse të artikullit/produktit duhet të kenë përputhshmëri të saktë dhe mbi to duhet të shënohen shenjat e prerjes dhe të bashkimit me njëra-tjetrën.*

### **Prerja**

*Procesi i prerjes duhet të bëhet me shumë kujdes për një shfrytëzim optimal të materialit. Buzët e detajeve të prera duhet të jenë të pastra sidomos në pjesët e harkuara. Prerja e lëndëve të para dhe ndihmëse ka të bëjë me prerjen me tranxhë sipas formave të përgatitura të materialeve që nevojiten për ndërtimin e këpucës. Këpucët e një pale duhet të priten nga e njëjta lëkurë për të shmangur tonalitetet në ngjyrë.*

*Prerjes në tranxhë sipas formave iu nënshtrohet lëkura boks vici, astari i meshinit, bombeja dhe forti termoplastik, kartoni dhe sholla.*

### **Markimi i pjesëve përbërëse të artikullit**

*Ky proces duhet të garantojë që të gjitha detalet e këpucës të kenë të njëjtën ngjyrë, pa tonacione të dukshme.*

### **Proçesi i prodhimit**

*Proçesi i prodhimit të këpucës ka të bëjë me qepjen dhe montimin e pjesëve përbërëse të këpucës sipas një procesi linear të përcaktuar. Ky proces ndahet në dy faza kryesore.*

*Faza e parë është përgatitja e pjesës së sipërme të këpuces gjatë të cilës realizohet bashkimi dhe qepja e pjesëve përbërëse prej lëkure së bashku me astarin e meshinit, fiksimi i bombës dhe fortit termoplastik si dhe fiksimi i kamaretës së celikut tek tabani.*

*Faza e dytë realizon dhënien e formës së pjesës së sipërme të këpucës me anë të presimit në kallëp, fiksimin e tabanit si dhe montimin e shollës. Punimet përfundimtare dhe lyerja me bojë janë fazat e fundit. Midis proceseve të ndërmjetme të kësaj faze për një përpunim sa më të mirë në përputhje me kërkesat teknologjike, gjysëmprodukti kalon dhe i nënshtrohet proceseve termike në furrën e ngrohjes.*

*“Këpucë me qafa dimërore” duhet të jenë e tipit klasik, pa qafe, me katër vrime, për përdorim të zgjatur gjatë sezonit të dimrit.*

## **NDËRTIMI I KËPUCËS**







***Pjesët përbërëse të këpucës:***

- *Faqja e sipërme (përpara)*
- *Faqja e sipërme mbrapa ( veshët)*
- *Fileta e thembrës*
- *Gjuhëza (llapa)*
- *Astari*
- *Pjesa e butë e thembrës,*

- Tabani
- Kupa e gishtave (bombeja) dhe kupa e thembrës (forti)
- Vrimat dhe lidhëset
- Sholla e jashtme (bashkë me takën)
- Goma

### **PJESA E SIPËRME E KËPUCËS (detajet, lloji i materialit dhe punimi)**

#### ***Pjesa e sipërme e përparme (faqja)***

Lloji i materialit i përdorur për pjesën e sipërme të përparme të këpucës dimërore duhet të jetë prej lëkure viçi (boks) me ngjyrë të zezë, me trashësi 1.6 mm. Faqja e përparme, faqet anësore, thembra, filetot e mbrapme dhe gjuhëza bashkohen me tegel linear një gjilpërësh dhe dy gjilpërësh. Faqet bashkohen me shtrojën, xhiron e gomës dhe shollën nëpërmjet procesit të ngjitjes dhe tegelave.

#### ***Pjesa e sipërme mbrapa (veshët)***

Lloji i materialit i përdorur për pjesën mbrapa duhet të ketë trashësi 1.4 deri 1,6 mm. Buzët e lira të veshëve, duhet të përshkohen nga një tegel linear perimetral një gjilpërësh që shërben edhe për qepjen e lëkurës me astarin e brendshëm të këpucës. Astari dhe lëkura duhet të jenë të palosur dhe të qepur me tegela të fshehtë tek buzët e lira të qafës dhe veshëve për të mbrojtur lëkurën e këmbës nga gërvishtjet. Tek ana e mbrapshtinës (veshët) deri në mbylljen e saj, kalojnë në të dyja anët tegela dy gjilpërësh perimetral, për zbukurim. Distanca e qepjes nga qafa deri në tegelat zbukurues është 15 mm.

#### ***Fileta***

Lëkura për filetën duhet të ketë të njëjtat karakteristika si të faqes.

Fileta qepet mbrapa nga të dyja anët. Ajo fillon nga lartësia e qafës dhe përfundon në shollë. Ajo vendoset në pjesën e pasme, në linjë me qendrën e takës. Kjo fileta është përshkruar me dy tegela dygjilpërësh që shërbejnë për mbylljen e mbrapshtinës. Distanca e tegelit nga buzët është 1mm.

Përmasat e filetës janë:

- me gjatësi rreth 118 mm ( në varësi të numrit të këpucës ),
- me gjerësi 17 mm në lartësinë e qafës
- me gjerësi 22mm në pjesën mesit
- me gjerësi 44 mm në pjesën fundore

#### ***Astari***

Këpuca duhet të jetë nga brenda e veshur me astar. Astari i faqes duhet të jetë prej meshin dhie. Kjo pjesë kapet me një tegel me pjesën e përparme të faqes së bashku me gjuhëzën. Pjesa e brendshme e thembrës duhet të jetë prej astar meshin dhie me trashësi mbi 0,9 – 1,2 mm, i cili duhet të përdoret nga ana e mishit. Ai do të vendoset në taban me ngjitje. Pjesa e brendshme e thembrës qepet me një tegel nën pjesën e brendshme të mbrapme dhe kapet me tegelin e mbrapshtinave.

### **Gjuhëza**

Materiali për gjuhëzën duhet të ketë trashësi 1,2 - 1,4 mm. Lëkura e gjuhëzës duhet të jetë më e butë se tek pjesët e tjera. Gjuhëza bashkohet me astarin me tegel qepës linear një gjilpërësh. Gjuhëza bashkohet me pjesën e përparme të faqes dhe astarin e faqes.

### **Pjesa e butë e thembrës**

Pjesa e butë e thembrës duhet të jetë e përbërë nga një shtresë sfungjeri ortopedik (memory foam) me përmasa 4 mm - 6 mm, shumë cilësor dhe të mbuluar me astar. Ai duhet të ngjitet dhe pastaj të qepet me shollën e brendshme me anë të një tegeli linear perimetral një gjilpërësh.

### **Tabani**

Tabani duhet të jetë prej celuloze (tip kartoni) të përforcuar e cilësisë së lartë, rezistente dhe elastike, me trashësi 1,9 – 2 mm. Ai duhet të lyhet me solucion kundra ujit. Tabanit, në pjesën e thembrës nga poshtë i vendoset një kamaretë (shirit çeliku) të kanalizuar me nervaturë me gjatësi 14 – 15 cm dhe gjerësi 8 – 10 mm.

Shiriti i çelikut vendoset nga fundi i thembrës në gjatësi nga 2,8 deri 3 cm larg qendrës së thembrës (pjesa e rrumbullakët) në brendësi. Kamareta e çelikut mbulohet më karton fibër të presuar, të përmasave 14 – 15 cm gjatësi dhe 6,4 – 6,5 cm gjerësi, sipas formës së tabanit.

Kamareta përputhet me boshllëkun që krijohet nga trashësia e faqes kur montohet në taban. Tabani barazohet dhe zmerilohen të dy anët.

### **Kupa e mbrapme (forti) dhe kupa e përparme (bombe)**

Forti duhet të jetë prej materiali termoplastik, që nuk thyhet, me trashësi 1,4 mm ± 0,1 mm. Ai vendoset në pjesën e mbrapme të këpucës. Forti ka formën e këmbës në pjesën e mbrapme dhe krijon një përputhje me të. Forti ngjitet midis pjesës së jashtme dhe të brendshme të mbrapme.

Bombeja duhet të jetë prej material termoplastik, që nuk thyhet, me trashësi 1,2 mm ± 0,1 mm. Ajo vendoset në pjesën e përparme, në majën e këpucës. Bombeja shtrohet midis pjesës së jashtme dhe të brendshme të përparme.

Bombeja dhe forti e marrin këtë formë gjatë punimit me nxehtësi në kallëpe me temperaturë të posaçme (vetëm për këto pjesë të këpucës). Bombeja dhe forti duhet të lyhen me solucion kundra ujit.

### **Vrimat e këpucës**

Vrimat e këpucës janë realizuar me syza metalike për kalimin e lidhësëve. Këpucët duhet të jenë me 4 vrima të barazlargura në të dy anët. Syzat metalike kanë diametër 7mm.

Tek pjesa e veshit ( tek vrimat ) vendoset një material përforcues nga ana e brendshme që ruan fortesën e lëkurës kur tërhiqet, në mënyrë që vrimat e lidhësëve të mos çahen edhe nëse tërhiqen fort.

### **Maja e këpucës**

Forma e majës së këpucës duhet të jetë rrumbullake.

## **PJESA E POSHTME E KËPUCËS (detajet, lloji i materialit dhe punimi)**

### **Shoje gome të presuar, tip “U”**

Sholla është prej gome, (nga poshtë është me kanale, lule etj), me relieve kundër rrëshqitjes. Pjesa e përparme ka një zbukurim me hallka gome të cilat janë 9 copë në secilën anë. Trashësia e hallkave është 3 mm nga baza e gomës dhe gjerësi prej 10mm.

Në mes të hallkave qendron një zbukurim në formë imitim qepje (efekt estetik).

Sholla fiksohet me ngjitës me 1 dhe 2 komponent me aktivizim. Temperatura e aktivizimit është 60-70 0C. Përmasat e shojeve të presuara maten me metër dhe mikrometër gome. Gjatësia matet ndërmjet dy ekstremeve të majës dhe thundrës, ndërsa trashësia matet në mesin e tabanit të shollës. Matjet mund të kryhen dhe me shabllon.

### **Taka e këpucës**

Taka ka një lartësi prej 38 mm e matur nga xhiro e gomës. Ajo përbëhet nga 4 hallka në secilën anë. Trashësia e hallkës është 3 mm dhe gjerësi prej 25 mm.

Taka e këpucës është unike. Ajo është një trup bashkë me kanalet apo lulet e poshtme dhe shollën. Ndarja në shtresa e gomës së takës, nuk lejohet. Në mes të hallkave qëndron një zbukurim si në pjesën e përparme imitim qepje që shërben për efekt estetik.

### **Goma**

Goma përbëhet nga dy pjesë.

Pjesa e përparme e shollës ka një dizenjo të veçantë, gjysma e saj përbëhet nga lule kundër rrëshqitjes.

Gjysma e takës në pjesën e mbrapme ka një vijëzim kundra rrëshqitjes dhe pjesa tjetër është lisho.

Goma duhet të jetë e përshtatshme për gjithë kohën e përdorimit. Ajo nuk duhet të krijojë probleme, nuk duhet të shtypet apo të konsumohet si nga ana e brendshme ashtu dhe nga ana e jashtme

Poshtë shollës, në pjesën e harkuar të saj ( në hapësirën që krijohet mes takës dhe pjesës së përparme) vendoset numri përkatës i këpucës. Numri është i rrethuar nga një vizë e lehtë. Ky numër vendoset me gdhendje për çdo këpucë dhe shënohet në anën e brendshme të shputës. Përreth gomës, nga sipër buzëve i aplikohet si një imitim qepje një gjilpërësh (zbukurim), i realizuar me presion në temperaturë të nxehtë.

## **KUSHTE TË DOMOSDOSHME**

- Produkti përfundimtar duhet të jetë identik me kampionin e aprovuar gjatë procedurave të vlerësimit.

- Këpucët duhet të jenë të qepura mirë, të jenë të buta, të lehta, të jenë të rehatshme në përdorim dhe të duken të rregullta kur të vishen nga punonjësit e Gardës së Republikës.

- Lëkura (boks viçi) quhet e cilësisë së parë kur ka të përpunueshme jo më pak se 92% të sipërfaqes. Tek lëkura defektet lejohen deri në 4% të sipërfaqes, nga të cilat jo më shumë se 2 % në kurriz (krupon).

- Lëkura për faqe këpucësh duhet të jetë:

- e butë dhe e vajosur mirë,

- e ngjeshur dhe kompakte,
  - e pastruar nga ana e mishit
  - e mbushur dhe e regjur shumë mirë
  - e shtrirë mirë në të gjithë sipërfaqen,
  - e barazuar dhe të zmeriluara
- Lëkura për faqe këpucësh dhe meshini duhet të ketë:
- rezistencë maksimale ndaj njollave, ujit dhe nxehtësisë,
  - ngjyrosje uniforme dhe të qëndrueshme në të gjithë sipërfaqen,
  - formë të rregullt.
- Meshini quhet i cilësisë së parë kur ka të përpunueshme jo më pak se 80% të sipërfaqes kur është i pangjyrosur dhe 90% të sipërfaqes kur është i ngjyrosur.
- Tek meshini i ngjyrosur defektet lejohen deri në 20% të sipërfaqes. Tek lëkura e kurrizit (kruponi) defektet lejohen nga 5-10% të sipërfaqes.
- Meshini duhet të jetë:
- i butë,
  - i pastruar nga ana e mishit nga mbeturina e skarnimit.
  - i ngjeshur dhe kompakt,
  - i shtrirë mirë në të gjithë sipërfaqen.
- Lëkura nuk duhet të egërsohet mbas lagies dhe montimit.
- Lëkura dhe meshini duhet t'i rezistojë tërheqjes dhe të mos çahet gjatë qepjes.
- Lëkura e këpucës duhet të ketë rezistencë maksimale ndaj përdorimit dhe konsumit.
- Lëkura duhet të ketë rezistencë maksimale ndaj përshkueshmërisë së ujit dhe të sigurojë ajërim të mirë të këmbës.
- Shojet e presuara, cilësia e parë, nuk duhet të bien në kontakt me vajra, lëndë kimike, benzinë dhe tretësira të tjerë organikë si dhe me pajisje ngrohëse.
- Shojet duhet të presohen me kujdes që të mos lindin vende të pambushura ose të çara.
- Shojet nuk duhet të kenë rrjedhje nga procesi i vullkanizimit, diferencë në trashësi, gropa, gunga, sipërfaqe jo të lëmuar dhe lulëzim të sqfurit.
- Filli qepës duhet të ketë ekzakt karakteristikat e përcaktuara tek Specifikimet Teknike.
- Tegelat e qepjes së këpucëve duhet të jenë me hap 3- 4 shpime në 1 cm.
  - Tegelat duhet të jenë të drejtë, uniforme, simetrik, me elasticitetin e duhur dhe nuk duhet të kenë shqepje ose defekte.
  - Tegelat duhet të jenë të fortë dhe qëndrueshmëria duhet të jetë mbi 9 kg.
  - Tegelat duhet të jenë të përforcuar në ekstremitete.
  - Nuk lejohet çarje nga gjilpëra dhe prishje tegeli.
- Të gjithë elementët e këpucës duhet të jenë simetrikë.

**Numrat e këpucëve do të jenë nga Nr. 36 - 46 .**

**Sasia sipas numërave do të bëhet mbi bazën e kerkesave të Gardës, me lidhjen e kontrates me prodhuesin.**

Përmasat e meposhteme i referohen këpuces Nr.41

Si bazë do të merren përmasat e Nr.41 me të dhëna si më poshtë:

- Gjatësia e kallëpit 275mm
- Gjerësia 255 mm
- Lartësia e qafës së këpucës e matur mbi xhiron e gomës duhet të jetë 120 mm  $\pm$  4 mm

Toleranca për gjatësinë është  $\pm$  6.67 mm dhe vlen për të gjitha gjatësitë.

Ndërsa për gjerësinë në gishta dhe në trinë tolerancat janë  $\pm$  5 mm për numrat e tjerë.

### **AMBALLAZHIMI, MARKETIMI DHE ETIKETIMI**

Secila palë e këpucëve duhet të pajisen me etiketa prej tekstili, në të cilat duhet të shkruhet ky informacion: emri i fabrikës, viti i prodhimit, përmasa dhe përbërja. Etiketa duhet të qepet në astarin e brendshëm të lapetës.

Masa e këpucëve, duhet të vendoset dhe poshtë shojeve të gomës në mënyrë të dukshme.

Në momentin e dorëzimit këpucët duhet të jenë të lyera me bojë, të pastëra dhe të rregullta. Paketimi i këpucëve duhet të bëhet në kuti të vogla kartoni. Në secilën kuti do të futen një palë këpucë dhe një qesë e vogël me silikon.

Të gjitha kutitë e vogla të të njëjtës masë do të vendosen në kuti kartoni të mëdha. Çdo kuti duhet të jetë e pajisur me një etiketë me adeziv, në të cilën duhet shënuar masa, viti i prodhimit, sasia dhe emri i fabrikës prodhuese. Kutitë duhet të jenë të padëmtuara dhe të izoluara me shirit ngjitës (natriban).

### **Garancia**

Garancia e këpucëve është 1 (një) vit.

Furnizuesi merr persiper zevendesimin e këpucëve të demtuara gjatë përdorimit brenda afatit të garancise për defekte që vijnë si rrjedhojë e procesit teknologjik lëndëve të para e ndihmese që përdoren.

**Afati i lëvrimit:** Brenda 90 ditëve nga lidhja e kontratës, por jo më vonë se data 20 dhjetor i vitit planifikues.

### **KOLAUDIMI, MARRJA NË DORZIM**

Pranimi i të gjithë sasisë së artikullit “Këpucë me qafa dimëri” të përcaktuar në kontratë dhe të dorëzuar në magazinën e Gardës, do të bëhet vetëm në bazë të rezultateve që do të merrën gjatë procesit të Kolaudimit për të gjithë sasinë e produktit të gatshëm të dorëzuar në magazinë. Kolaudimi do të bëhet mbi bazën e rezultateve të Fletë-analizave laboratorike të lëshuara nga Laboratore te Akredituar te Lëkurë – Këpucës, që shoqërojnë mallin, të sjella nga kontraktuesi, sipas përcaktimeve në kontratë, dhe ekzaminimit e testimi të mallit të furnizuar, që do të bëjë Komisioni i pritjes, kontrollit dhe pranimit të mallit të Gardës së Republikës, pranë laboratorëve të akredituar, duke i krahasuar rezultatet e tyre me rezultatet e analizave të sjella nga OE furnizues”. Gjithashtu, komisioni kryen direkt matjet dhe provat fizike të sasisë së mallit të dorëzuar dhe bën krahasimin e të gjithë këtyre rezultateve me kerkesat dhe të dhënat teknike të këtij specifikimi teknik, kampionit të ofruar dhe modelit të miratuar.

**Artikulli konsiderohet teknikisht i pranuar kur ai ploteson të gjitha kërkesat e këtij Specifikimi Teknik.**

### SPECIFIKIME - TEKNIKE

**OBJEKTI :** “Këpucë me qafa shërbimi e stërvitje” për punonjësit e Gardës së Republikës.

Ky specifikim teknik në mënyrë të detajuar paraqet kërkesat themelore teknike të domosdoshme për prodhimin e artikullit “Këpucë me qafa shërbimi e stërvitje “. Në këtë specifikim teknik përcaktohen gjithashtu dhe kërkesat teknike të aksesoreve që shoqerojnë artikullin “Këpucë me qafa shërbimi e stërvitje” si produkt të gatshëm .

**Të gjitha përcaktimet teknike të këtij specifikimi teknik duhen të zbatohen detyrimisht saktë nga prodhuesi.**

Per procedure vleresimi dhe miratimi nga perdorusi, ofertuesi eshte i detyruar te paraqese si oferte teknike te realizuar sipas kerkesave te këtij specifikimi teknik:

- a. 1(një ) palë këpucë Nr 42, mostra duhet të ketë të trupezuar vulën dhe etiketen orgjinale të fabrikes prodhuese.
- b. 1 (një ) cope lekure natyrale vaqet tip U me permasa 30 x 30 cm, me vulë dhe etikete orgjinale të ofertuesit, të trupezuar.
- c. 1(një) copë astar meshini dhie, me permasa 30 x 30 cm me vulë dhe etikete orgjinale të ofertuesit të trupëzuar.
- d. Fletë analize laboratorike të treguesve fiziko–mekanik e kimik të lëndës së parë lekurë natyrale vaqet dhe astarit meshin dhie.

Lekura e mostres, lëndës së parë dhe ajo që i bashkëngjitet raport-analizes duhet të jenë detyrimisht të njëjta.

**Mungesa e mostres, lëndës parë dhe fletë analizës që shoqeron ato është kusht skualifikues.**

### **KARAKTERISTIKA TE PERGJITHESHME**

Këpucët shërbimit e stërvitjes të jenë me qafa te gjata dhe ngjyre te zeze.

Lartësia e qafës së këpucës 210 +/- 2 mm (e matur mbi xhiron e gomës)

Lartësia e takes 30 mm +/- 2 mm (24 mm te jetë sholle gome e presuar dhe 6 mm të jetë thellesia e dhëmbëzave ose lulës).

Menyra e lidhjes së qafave : të jetë me lidhese të zeza me gjatesi 140 cm +/-5 cm, qafa të jenë e paisur me (9 çifte) syze metalike me diametër 7mm të barazlanguara në gjithë lartesine e saj dhe lapete në lartësinë e qafes.

Lidheshet të jene sintetike në forme kordoni, të forta.

### **LENDET E PARA DHE NDIHMESE**



- **Lekura te jete lekure natyrale vaqet kundra ujit, cilesia e pare me keto te dhena (sipas STASH 1143 – 89) :**
  - ngjyra **e zeze**
  - çngjyrosja **> nota 4**
  - trashesia **1.6 – 1.9 mm**
  - yndyra **8 -11 %**
  - rezistenca ndaj plasjes se faqes **> 1.6 kG/mm<sup>2</sup>**
  - rezistenca ndaj keputjes se faqes **> 2.0 kG/mm<sup>2</sup>**
  - zgjatimi ne ngarkese **15 – 25 %**
  - qendrueshmeria deri ne keputje **deri ne 70 %**
  - penetrimi i ujit gjendje statike **> 240 minuta**
  - rregjia **0 % rregjia shume e mire**
- **Astari per te gjitha pjeset e brendeshme te jete meshin dhije,me keto te dhena (sipas STASH 1144 – 89) :**
  - ngjyra **te jete e ngjyrosur**
  - trashesia **0.9 – 1.2 mm**
  - yndyra **4 -7 %**
  - rezistenca ndaj plasjes se faqes **> 1.3 kG/mm<sup>2</sup>**
  - rezistenca ndaj keputjes se faqes **> 1.5 kG/mm<sup>2</sup>**
  - zgjatimi ne ngarkese **15 – 30 %**
  - rregjia **0 % rregjia shume e mire**
- Ngjitesa me 1 komponente dhe per ngjitjen e pjeses se poshteme (sholles me fjapen) me 2 komponente.
- Penj sintetik me ngjyre te zeze per qepje e lekures 100 % sineteik dhe qendrueshmeri mbi 9 kG,per masurin Nm 40/3 dhe gjilperen Nm 30/3
- Penj sintetik i thurur 1 mm per qepje 100 % PES dhe rezistence 38 kG (1000 g)
- Bombe termoplastike me trashesi 1.4 deri 1.7 mm.
- Forte soleti me trashesi 2.5-3.2mm.
- Taban soleti me trashesi 3 deri 3.5 mm.
- Fjap gome me trashesi 4 deri 4.2 mm, e shoqeruar me xhiro gome me pjerresi konike dhe gjeresi te saj 17-19 mm. sipas STASH 2896–87
- Pjesa e poshtme te jete gome e presuar me fortesi 75 +/-3 grade shore (sipas STASH 2638-87), cilesia e pare. Goma e presuar poshte te jete e dhembzuar ose me lule ne pjesen me llokma trashesia te jete 13-14 mm ndersa pa llokma trashesia te jete 7-8 mm.
- Astar shtroje karton fiber me trashesi 1.4 – 1.7 mm.
- Kamarete e kurbezuar me gjeresi 17 –20 mm dhe gjatesi sa 1/3 e gjatesise se kepuces.
- Rezistenca ne shqitje e gomes: shume e mire sipas (STASH 1150/8-89).
- Percaktimi i qendrueshmerise se ngjyres: Ne te thate nuk lejohet çngjyrosja (STASH 1150/7-89).
- Sfungjer për qafën e këpucës me trashësi 6 mm
- Sfungjer për mbushjen e lapetës me trashësi 3 mm

### **Procesi i prodhimit**

### **Kolaudimi i lendes se pare dhe materialeve ndihmese**

*Kolaudimi i lendes se pare dhe materialeve ndihmese ne menyre te sakte dhe te drejte eshte baze per nje ecuri cilesore te procesve teknologjike te metejshme zinxhir per prodhimin me cilesi te artikullit “Këpucë me qafa shërbimi e stërvitje”.*

#### **Prerja**

*Procesi i prerjes kryhet me tranxhe me ane te formave te pergatitura dhe duhet te behet me shume kujdes per nje shfrytezim sa me optimal te materialit qe pritet. Buzet e detajeve te prera duhet te jene te pastra sidomos ne pjeset e harkuara. Prerjes me tranxhe sipas formave iu nenshtrohet lekura boks vici, astari i meshinit, bombes dhe fortit termoplastik, kartonit dhe tabanit prej soleti lekure.*

#### **Pergatitja me presim e fiapes dhe e sholles**

*Ne kete proces prodhohet fiapa dhe sholla me ane te presimit ne te nxehte te materialit granul. Xhiroja eshte e presuar se bashku me fiapen ne nje trup te vetem ne menyre uniforme pergjate gjithe buzeve te saj. Taka e kepuces presohet se bashku me shollen. Taka nga poshte eshte me relief dhe se bashku me shollen ka lartesi 30 mm. Gjate ketij procesi duhet bere shume kujdes qe fiapa dhe sholla nuk duhet te kene rrjedhje nga procesi i vullkanizimit, difference ne trashesi, gropa, gunga, siperfaqe jo te lemuar dhe lulezim te sqfurit.*

#### **Procesi i prodhimit te kepuces ndahet ne dy faza kryesore.**

*Faza e pare eshte pergatitja e pjeses se siperme te kepuces gjate te ciles realizohet bashkimi dhe qepja e pjeseve perberese prej lekure vaqet vici Tip U, te kepuces se bashku me astarin e meshinit, fiksimi i bombes dhe fortes termoplastike si dhe fiksimi i kamaretes se celikut tek tabani prej soleti.*

*Faza e dyte realizon dhenien e formes se pjeses se siperme te kepuces me ane te presimit ne kallep, fiksimin e tabanit si dhe montimin e fjapes dhe te sholles, punimet perfundimtare dhe lyerjen me boje. Midis proceseve te ndermjetme te kesaj faze per nje perpunim sa me te mire ne perputhje me kerkesat teknologjike gjysemprodukti kalon dhe i nenshtrohet dhe proceseve termike ne furren e ngrohjes.*

*Ne fazen e pare pjeset e prera te lekures bashkohen me njera tjetren me ane te procesit te qepjes. Faqja (pjesa e perparme) eshte me trashesi 4-4.2 mm. Gjeresia e pjeses se mbyllur te faqes me pjesen e perparme duhet te jete e pergatitur ne menyre te tille qe mundesoje nje zmerilim dhe barazim sa me te mire. Gjeresia e pjeses qe mbyllet ne anen e jashtme tek veshet (pjesa e siperme e mbrapme) duhet te jete deri ne 1 mm. Tegeli me hap 6-8 hapa ne 1 cm duhet te jete 1 mm larg buzeve. Fileta qepet mbrapa ne te dy anet e saj me tegel 1 mm larg buzeve.*

*Lapeta (gjuhëza) bashkohet me pjesën e përparme të faqes dhe astarin e faqes me tegel qepës linear një gjilpërësh. Gjatësia e gjuhëzës është sa lartësia e këpucës. Lëkura e gjuhëzës duhet të jetë më e butë se tek pjesët e tjera. Në gjuhëz, në pjesën e kurrizit të këmbës në qendër, në mënyrë të barazlartuar në të dy anët me gjerësinë 2,2 cm +/- 1 mm, vendoset material i butë (sfungjer) me trashësi 3 mm.*

Astari meshin vendoset duhet te vendoset ne te gjithë sipërfaqen e brendshme te kepuces. Fodera e faqes (pjesa e perparme ndermjetese) me trashesi 0.9 mm fiksohet me faqen si me ngjitje ashtu dhe me qepje. Fodera e veshit (pjesa e mbrapme ndermjetese) me trashesi 0.9 mm e fiksuar me mbrapshtinen me ngjitje duke u kapur njekohesisht me tegelin e mbylljes gjate qepjes se mbrapshtinave dhe te filetes. Astartet shtroje me trashesi 1.4-1.7 mm vendosen me ngjitje.

Gjate procesit te qepjes te pjeseve te lekures me astarin kryhet njekohesisht dhe procesi i fiksimit te bombes termoplastike dhe fortit termoplastik. Bombeja vendoset me ngjitje tek maja e kepuces midis pjese se sipërme dhe te poshtme ne largesi 6-8 mm nga buzet e faqes se pjeses se sipërme. Forti vendoset me ngjitje tek pjesa e mbrapme e kepuces midis pjese se jashtme dhe te brendshme ne largesi 10 mm nga buza e filetos nen pjesen e mbrapme.

Tegelat e qepjes tek faqja, mbrapshtinave, fileteve dhe sipërines se vesheve realizohen me pe me Nm 40/3 dhe Nm 30/3. Tegelat duhet te jene 1-2 mm larg buzeve dhe me hap 3-4 hapa ne 1 cm. Mbyllja e faqes realizohet me makine dygjilpershe ku distanca ndermjet tegelave paralel duhet te jete 3-4 mm. Per te realizuar nje perforcim sa me te forte gjate mbylljes se sipërines tegelat qepen dyfish. Tegelat duhet te jene te rregullt, te forte, pa vende te shqepura dhe te perforcuar ne fund.

Tabani prej soleti lekure natyrale duhet te jete i barazuar dhe i zmeriluar ne te dy anet. Tabanit nga poshte duke filluar qe nga pjesa e rrumbullaket te fundi i thembres i fiksohet kamareta, nga fundi i thembres ne gjatesi dhe 2.8-3 cm larg qendres se thembres (pjesa e rrumbullaket). Kamareta ne te gjithë gjatesin e saj duhet te mbulohet me karton fiber te presuar me gjatesi 14-15 cm dhe gjeresi 6.4- 6.6 cm.

Ne fazen e dyte gjysemprodukti i perfunduar (pjesa e sipërme e kepuces) kalon ne procesin e dhenies se formes se kepuces me ane te fiksimit neper kallep te gatshem. Gjate ketij procesi behet njekohesisht dhe vendosja e tabanit ne menyre te tille qe kamareta e celikut te perputhet plotesisht me boshllekun qe krijohet nga trashesia e faqes. Gjysemprodukti i nenshtrohet procesit te zmerilimit dhe barazimit te pjeses se poshtme gjate te cilit duhet bere kujdes qe te eliminohen te gjitha palat, kanalet ose te ngriturat sidomos ne maje, ne thember dhe ne pjesen qendrore te jashtme dhe te brendshme te tij duke bere nje barazim sa me te mire te sipërfaqes se pjeseve te kthyera te lekures. Zmerilimi dhe barazimi shume i mire ben te mundur realizimin me cilesi te larte te procesit te fiksimit te fiapes me tabanin.

Fiapa fiksohet me tabanin dhe pjesen e poshtme te gjysemproduktit me ngjitje. Per ngjitjen perdoret material ngjites me nje komponent. Materiali ngjites duhet te perhapet si ne te gjithë sipërfaqen e sipërme te fiapes ashtu dhe ne te gjithë sipërfaqen e pjeses se poshtme te gjysemproduktit. Ngjitja duhet te kryhet ne te gjithë sipërfaqen e fiapes dhe pjeses se poshtme te gjysemproduktit. Ngjitja duhet te jete shume e mire. Rezistenca e ngjitjes se fiapes me tabanin duhet te jete e larte. Qepja e fiapes me tabanin behet brenda dhe jashte dhe kryhet me makine. Per qepje perdoret pe sintetik me fortesi 38 kG me hap te tegelit 4 hapa ne 3 cm. Tegeli duhet te jete shume i forte dhe nuk duhet te dali jashte buzeve te fiapes ose te tabanit. Kanali i fiapes duhet te jete me gjeresi 2 mm dhe thellesi 1.5 mm. Distanca nga kendi i prerjes se fiaps ne mesin e kanalit duhet te jete 10-12 mm.

Sholla fiksohet me fiapen me ngjitje duke perdorur material ngjites me dy komponente. Materiali ngjites duhet te perhapet si ne te gjithë sipërfaqen e poshtme te fiapes ashtu dhe ne te gjithë sipërfaqen e pjeses se sipërme te sholles. Ngjitja duhet te kryhet ne te gjithë sipërfaqen e sholles dhe fiapes dhe te jete shume e mire. Rezistenca e ngjitjes se fiapes me

tabanin duhet te jete mbi 35 N. Sholla nga poshte duhet te jete me llokma. Taka eshte e presuar se bashku me shollen. Lartesia e takes se bashku me xhiron dhe fiapen duhet te jete 30-32 +/-1mm.

Ne brendesi te kepuces siper te gjithe siperfaqes se tabanit me ngjitje dhe e shtrire mire vendoset si shtroje astar meshini me trashesi 1.4-1.7mm. Midis asatrit dhe tabanit ne qender te pjeses ku vendoset dhe qendron shputa e kembes duhet te jete fiksuar me ngjitje material i bute (sfungjer i presuar).

Ne perfundim behet zmerilimi dhe barazimi i buzeve te bashkimit te fiapes me shollen,perpunimet perfundimtare te rifinitures dhe lyerja me boje.



### **Klasifikimi**

**a.** Numrat e kepuceve do te jene nga Nr. 36 – 46.

**Sasia sipas numerave do te behet mbi bazen e kerkesave te Gardes, me lidhjen e kontrates me prodhuesin.**

**b.** Kepucet prodhohen me 2 fraksione me gjatesi dhe gjeresi te ndryshme sipas numrave. Permasat e meposhteme i referohen kepuces Nr.41

**FRAKSIONI I PARE (A)**

( i ngushte )

gjatesia 273 mm

gjeresia 259 mm

**FRAKSIONI I DYTE (B)**

( i gjere )

gjatesia 275 mm

gjeresia 260 mm

Toleranca per gjatesine eshte **6.67 mm** dhe vlen per te gjitha gjatesite ndersa per gjeresine eshte 5 mm dhe vlen per te gjitha gjerese.

Gjeresia ne pjesen e gishtave duhet te jete 268 +/- 2mm ndersa gjeresia ne pjesen e trines 275 +/- 2mm. Gjeresia ne kontropjede duhet te jete 385 +/- 2mm.

**Lartësia e qafës së këpucës** duhet të jetë 210 +/- 2 mm e matur mbi xhiron e gomës.

Në të gjithë pjesën lart të qafës së këpucës, midis vrimës së lidhëseve 8 dhe 9 (sa gjerësia e tyre), 2 cm larg buzeve (vrimës së lidhëseve ) vendoset sfungjer me trashësi 6 mm dhe me gjerësi 3 cm +/-1mm, për ta bërë plotësisht komode gjatë përdorimit. Sfungjeri vendoset midis astarit dhe lëkurës dhe qepet nga brenda dhe jashtë me fije poliestër.

Artikulli “Këpucë me qafa shërbimi e stërvitje” është i njejtë si për meshkuj ashtu dhe për femra.

### **Ambllazhimi, marketimi dhe etiketimi**

Këpuca marketohet ne pjesen e mbrapshtines me ane te vulosjes me boje sipas fraksionit (A) ose (B) muaji e viti i prodhimit.

Sholla (goma e presuar) ne pjesen e poshteme ka te stampuar numrin e kepuces.

Kepucet ambllazhohen me fraksionet perkatese : ne nje kuti te vogel vendosen 1 (nje) pale kepuce dhe ne 1 (nje) kuti te madhe kartoni ambllazhohen 10 (dhjete) ose 15 (pesembedhjete) pale kepuce. Kutia duhet te kete numrin e kepuces.

### **Garancia**

Garancia e kepuceve eshte 1 (nje) vit.

Furnizuesi merr persiper zevendesimin e kepuceve te demtuara gjate perdorimit brenda afatit te garancise per difekte qe vijne si rrjedhoje e procesit teknologjik lendeve te para e ndihmese qe perdoren.

**Afati i lëvrimit:** Brenda 90 ditëve nga lidhja e kontratës, por jo më vonë se data 20 dhjetor i vitit planifikues.

### **Kolaudimi, marrja ne dorzim**

Pranimi i të gjithë sasisë të artikullit “Këpucë me qafa shërbimi e stërvitje” të përcaktuar në kontratë dhe të dorëzuar në magazinën e Gardës, do të bëhet vetëm në bazë të rezultateve që do të merrën gjatë procesit të Kolaudimit për të gjithë sasinë e produktit të gatshëm të dorëzuar në magazinë. Kolaudimi do të bëhet mbi bazën e rezultateve të Fletë-analizave laboratorike të lëshuara nga Laboratore te Akredituar te Lëkurë – Këpucës, që shoqërojnë mallin, të sjella nga kontraktuesi, sipas përcaktimeve në kontratë, dhe ekzaminimit e testimit të mallit të furnizuar, që do të bëjë Komisioni i pritjes, kontrollit dhe pranimit të Gardës së Republikës, pranë laboratorëve të akredituar, duke i krahasuar rezultatet e tyre me rezultatet e analizave të sjella nga OE furnizues”. Gjithashtu, komisioni kryen direkt matjet dhe provat fizike të sasise së mallit të dorëzuar dhe bën krahasimin e të gjithë këtyre rezultateve me kerkesat dhe të dhënat teknike të ketij specifikimi teknik, kampionit të ofruar dhe modelit të miratuar.

**Artikulli konsiderohet teknikisht i pranuar kur ai ploteson të gjitha kërkesat e këtij Specifikimi Teknik.**

III.3.4. Në nenin 77 pika 1 dhe pika 4 “Kërkesat për kualifikim” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikon shprehimisht se: Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

[...]

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

III.3.5. Në nenin 40 pika 6 germa a) “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit;

III.2.3. Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë se operatorët ekonomikë duhej të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato.

Referuar kriterëve të veçanta të kualifikimit, në pikën 2.3.8 të Kapacitetit teknik, rezulton, se është kërkuar shprehimisht, që operatorët ekonomikë pjesëmarrës, ditën e hapjes së dokumentacionit në fazën e parë, duhet të depozitojnë pranë Agjencisë Shtetërore të Prokurimeve të Përqëndruara, mostrat e artikujve sipas tabelës 1, konkretisht Këpucë me qafa sherbimi e stervitje, Këpucë me qafa dimri, Këpucë gjysma uniforme, mostrat duhet të kenë të trupezuar vulën dhe etiketen orgjinale të fabrikes prodhuese; cope të lëndës së parë me permasa 30 x 30 cm, me vulë dhe etikete orgjinale të ofertuesit, Lloji i mostres, lëndës së parë dhe ajo që i bashkëngjitet raport-analizes duhet të jenë detyrimisht të njëjta; Fletë analize laboratorike të cilat duhet të jenë të realizuara nga laboratorë të akredituar sipas akreditimeve kombëtare dhe/ose ndërkombëtare. Këto testime duhet të jenë në përputhje të plotë me specifikimet teknike. Në rast se testimet do të jenë realizuar nga laboratorë ndërkombëtar të paraqiten të dhënat si më poshtë për laboratorët si emri i laboratorit, institucioni akreditues, të dhënat e kontaktit.

Referuar shtojcës 7 “Specifikimet teknike” autoriteti kontraktor ka kërkuar që: për objektin “Këpucë gjysmë uniforme” për punonjësit e gardës së republikës, ofertuesi është i detyruar të paraqesë si ofertë teknike të realizuar sipas kërkesave të këtij specifikimi teknik: 1(një) palë këpucë Nr. 42, 1 (një ) copë lëkurë natyrale boks vici me përmasa 30 x 30 cm, me vulë dhe etikete origjinale të ofertuesit, të trupëzuar, 1(një) cope astar meshini dhie, me përmasa 30 x 30 cm me vulë dhe etikete origjinale të ofertuesit të trupëzuar, Fletë-analize laboratorike të treguesve fiziko–mekanik e kimik të lëndës së parë lëkurë natyrale boks vici dhe astarit meshin dhie. Lëkura e mostrës, lëndës së parë dhe ajo që i bashkëngjitet raport-analizës duhet të jenë detyrimisht të njëjta.

Për objektin “Këpucë me qafa dimërore” për punonjësit e gardës së republikës, për procedure vlerësimi dhe miratimi nga perdoruesi, ofertuesi është i detyruar të paraqesë si ofertë teknike të realizuar sipas kërkesave të këtij specifikimi teknik: 1(një) palë këpucë Nr. 42, mostra duhet të ketë të trupezuar vulën dhe etiketen orgjinale të fabrikes prodhuese, 1 (një) copë lëkurë natyrale lëkurë viçi (boks) cilësia e parë me përmasa 30 x 30 cm, me vulë dhe etikete origjinale të ofertuesit, të trupezuar, 1(një) cope astar meshini dhie, me përmasa 30 x 30 cm

me vulë dhe etiketë origjinale të ofertuesit të trupezuar, Fletë-analize laboratorike të treguesve fiziko–mekanik e kimik të lëndës së parë, lëkurë viçi (boks) cilësia e pare dhe astarit meshin dhie.

Lekura e mostrës, lëndës së parë dhe ajo që i bashkëngjitet raport-analizes duhet të jenë detyrimisht të njëjta.

Për objektin “Këpucë me qafa shërbimi e stërvitje”, për punonjësit e Gardës së Republikës, për procedure vlerësimi dhe miratimi nga perdorusi, ofertuesi është i detyruar të paraqesë si oferte teknike të realizuar sipas kërkesave të këtij specifikimi teknik: 1(një) palë këpucë Nr 42, mostra duhet të ketë të trupezuar vulën dhe etiketen origjinale të fabrikes prodhuese, 1 (një) copë lekure natyrale vaqet tip U me permasa 30 x 30 cm, me vulë dhe etikete origjinale të ofertuesit, të trupezuar, 1(një) copë astar meshini dhie, me përmasa 30 x 30 cm me vulë dhe etiketë origjinale të ofertuesit të trupëzuar, Fletë analize laboratorike të treguesve fiziko–mekanik e kimik të lëndës së parë lekure natyrale vaqet dhe astarit meshin dhie. Lëkura e mostrës, lëndës së parë dhe ajo që i bashkëngjitet raport-analizes duhet të jenë detyrimisht të njëjta.

Siç rezulton nga kriteret e veçanta të kualifikimit shtojca 9, pika 2.3.8, operatori ekonomik duhet të paraqesë fletë-analizën lidhur me testimet e realizuara nga laboratorët kombëtar dhe/ose ndërkombëtar në përputhje të plotë me specifikimet teknike ndërsa, referuar shtojcës 7 “Specifikimet Teknike”, operatori ekonomik duhet të paraqese fletë analizë laboratorike të treguesve fiziko mekanik e kimik të lëndës së parë lëkurë natyrale boks viçi dhe astarit meshin dhie, lëkurë natyrale vaqet dhe astarit meshin dhie. Komisioni gjykon, se në këto kushte kriteri i përcaktuar nga autoriteti kontraktor krijon paqartësi tek operatorët ekonomikë lidhur me të dhënat që duhet të përmbajë fletë analiza laboratorike, pra nëse duhet t’i referohen vetëm lëndës së parë apo testeve në përputhje me të gjithë specifikimet teknike, pra lëndës së parë e ndihmëse.

Sa më sipër cituar, Komisioni i Prokurimit Publik thekson, se autoriteti kontraktor duhet të hartojë dhe të përcaktojë kërkesat e veçanta për kualifikim në mënyrë më të qartë, duke përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë kriteret në përputhshmëri me objektin e kontratës.

III.2.4. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt-prokurimi, si dhe aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me kriterin e veçantë të vendosur. Sa më sipër, Komisioni gjykon, se autoriteti kontraktor nuk i ka hartuar dokumentet e tenderit në përputhje me nenin 77 të ligjit për prokurimin publik, pasi kriteri i vendosur është një kriter i paqartë. KPP gjykon, se vetë ligjvënësi ka parashikuar në nenin 2 gërma “dh”, se qëllimi i ligjit të prokurimit publik është ndër të tjera të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik. Ashtu si edhe GJED ka nënvizuar ndër vite, parimi i transparencës dhe barazisë janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën, por detyra thelbësore e transparencës në një procedurë



prokurimi është që të krijohen kushte dhe rregulla të hollësishme për të gjitha palët në proces. Komisioni i Prokurimit Publik thekson, se kriteret e veçanta për kualifikim nga autoriteti kontraktor duhet të përcaktohen të qarta, të sakta dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi, me qëllim që të kryhet një vlerësim i drejtë dhe jodiskriminues, duke mos penguar pjesëmarrjen në një procedurë prokurimi, si dhe t'i japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës.

III.2.5. Bazuar në nenin 118, pika 2, gërma “b” të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, sipas të cilit: *“Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë: të pranojë ankesën dhe të urdhërojë autoritetin ose entin kontraktor të anulojë plotësisht ose pjesërisht një veprim ose vendim, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin”*; nenit 98, pika 1, gërma “d” të këtij ligji ku thuhet shprehimisht: *“Autoriteti ose enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin sipas parashikimeve në këtë ligj”*, si dhe në nenin 45, pika 1 gërma “b” të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, ku parashikohet se: *“[...]Komisioni i Prokurimit Publik në kuadër të veprimtarisë së shqyrtimit të ankesave para lidhjes së kontratës procedon me: b) Vendim për pranimin e ankesës dhe urdhërimin e autoritetit/entit kontraktor, që të anulojë plotësisht ose pjesërisht një veprim ose vendim, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” [...]”*, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se mospërputhja e krijuar midis kërkesave të parashikuara nga autoriteti kontraktor në kriteret e veçanta të kualifikimit, si dhe në specififikimet teknike ndikon drejtpërdrejtë në hartimin e ofertës ekonomike të operatorëve ekonomikë të interesuar, si dhe në vlerësimin e ofertave nga ana e KVO-së, ndaj përbën shkak për anulimin e procedurës së prokurimit, me qëllim trajtimin e barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë. Në këto kushte, KPP gjykon se autoriteti kontraktor duhet të anulojë procedurën e prokurimit dhe në rishpalljen e saj të mbajë në konsideratë konstatimet e këtij vendimi.

III.3 Lidhur me ankesën e paraqitur në datën 12.06.2023 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është protokolluar ankesa me nr.1339 prot., e operatorit ekonomik “Gentian Sadiku” PF, në lidhje me procedurën e prokurimit. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua, se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “Gentian Sadiku” PF.

III.3.1 Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. 1339/2 prot., datë 13.06.2023 lidhur me arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues “Gentian Sadiku” PF në procedurën e mësipërme të prokurimit.

III.3.2. Me anë të shkresës Nr. 834/4 prot., datë 20.06.2023, protokolluar me tonë me nr. 1339/3 prot., datë 21.06.2023, autoriteti kontraktor ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacion mbi procedurën e mësipërme të prokurimit, si dhe aktin e trajtimit të ankesës të operatorit ekonomik “Gentian Sadiku” PF, ku konstatohet se ankesa e këtij të fundit është refuzuar.

III.3.3. Neni 24, pika 1, “Komisioni i prokurimit Publik” i Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon se: “Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë administrativ në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit dhe kryen çdo detyrë tjetër që i ngarkohet me këtë ligj dhe akte të tjera ligjore brenda fushës së kompetencave të tij.”.

III.3.4. Neni 30, pika 1, “Veprimtaria e Komisionit të Prokurimit Publik” i Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon se: “Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarët për procedurat e tjera. Shqyrtimi i ankesave për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar do të bëhet nga 3 anëtarë të Komisionit të Prokurimit Publik”.

III.3.5. Neni 110, pikat 3, 7 dhe 8 “Afatet për ankimim” i Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon se: “3. Në procedurat e prokurimit me faza mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e përzgjedhjes së kandidatëve pas fazës së parakualifikimit, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga marrja e njoftimit për këtë vendim.

Në procedurat e prokurimit me faza nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.

7. Në rast se operatori ekonomik nuk paraqet ankesën brenda afateve të parashikuara në këtë nen, atëherë nuk ka mundësi të ushtrojë më të drejtën e ankimit pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

8. Të shtunat, të dielat dhe ditët e festave zyrtare nuk pengojnë fillimin dhe kohëzgjatjen e afateve. Kur dita e fundit e një afati bie e shtunë, e diel ose një ditë feste zyrtare, afati mbaron në ditën e punës që vjen pas saj. Ankesa quhet e pranuar në ditën e depozitimit të saj pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.”.

III.3.6. Neni 111, pika 1, i Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon se: “1. Operatori ekonomik ankimes dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik. Rregulla të posaçme për mënyrën e paraqitjes së ankesës përcaktohen në rregullat e prokurimit publik.”.

Neni 112, pikat 1 dhe 2 i Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon se: “1. Me marrjen e ankesës, autoriteti ose enti kontraktor konfirmon në databazën e të dhënave të publikuara nga Komisioni i Prokurimit Publik që ankesa është paraqitur pranë këtij

*institucioni. Nëse autoriteti ose enti kontraktor konstaton se ankesa nuk është paraqitur në Komisionin e Prokurimit Publik, e refuzon atë si të pavlefshme.*

*2. Pasi konfirmon se ankesa është paraqitur në Komisionin e Prokurimit Publik, autoriteti ose enti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit deri në shqyrtimin plotësisht të ankesës, përfshirë edhe nxjerrjen e një vendimi nga Komisioni i Prokurimit Publik.”.*

III.3.7. Komisioni duke iu referuar dosjes së tenderit në rubrikën “Të dhënat kryesore” vëren, se kjo procedurë është “E kufizuar”, çfarë do të thotë se është autoriteti kontraktor ai që përcakton llojin e procedurës dhe mbi bazën e saj KPP shprehet së pari për respektimin e kushteve formale, ku njëri prej të cilëve është edhe respektimi i afateve ligjore të ankimit. Në këtë kuadër referuar llojit të procedurës “E kufizuar” dhe bazës ligjore të sipërcituar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se afati për dorëzimin e ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, në procedurat e prokurimit me faza nën kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për kundërshtimin e vendimit të përzgjedhjes së kandidatëve pas fazës së parakualifikimit, është 7 ditë nga marrja e njoftimit për këtë vendim. Në rastin konkret referuar sistemit elektronik rezulton, se njoftimi i vendimit për përzgjedhjen e kandidatëve pas fazës së parë të kualifikimit është kryer me datë 01.06.2023. KPP vëren, se operatori ekonomik “Gentian Sadiku” PF, ka dorëzuar ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik në datën 12.06.2023.

Referuar dokumentacionit të administruar rezulton, se operatori ekonomik “Gentian Sadiku” PF ka dorëzuar ankesën pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik jashtë afatit të parashikuar nga neni 110 pika 3 e ligjit 162/2020, i cili parashikon se “3. Në procedurat e prokurimit me faza mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e përzgjedhjes së kandidatëve pas fazës së parakualifikimit, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga marrja e njoftimit për këtë vendim.

Në procedurat e prokurimit me faza nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.”

Sipas parashikimeve të sipërcituara, në rastin konkret llogaritja e afatit për ankim pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, nis ditën e marrjes së njoftimit mbi vendimin e përzgjedhjes së kandidatëve pas fazës së parakualifikimit me datë 01.06.2023 dhe përfundon në ditën e 7-të. Në këtë rast, afati i fundit për paraqitjen e ankesës në autoritetin ose entin kontraktor, si dhe njëkohësisht në Komisionin e Prokurimit Publik, referuar datës së njoftimit të vendimit të përzgjedhjes së kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ka qenë data 07.06.2023. Ndërkohë ankesa e depozituar në autoritetin kontraktor dhe në Komisionin e Prokurimit Publik respektivisht me datë 12.06.2023, konsiderohet e paraqitur jashtë afateve ligjore të ankimit duke mos u legjitimuar *ratione temporis.*

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se ligji *stricto sensu* ka parashikuar se ankesa dorëzohet njëherazi si pranë autoritetit ose entit kontraktor ashtu edhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe është përgjegjësi e operatorit ekonomik ankimues, që të dorëzojë këtë të fundit njëherazi në të dyja institucionet, brenda afatit të parashikuar në ligj.

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se ligjvënësi ka parashikuar në mënyrë të qartë mënyrën mbi llogaritjen e afateve të ankimit, duke vendosur në pikën 8 të nenit 110 të ligjit për prokurimin publik rregullimin e posaçëm mbi llogaritjen e afateve. KPP nënvizon faktin, se një ndër parimet kryesore të së drejtës është ai se *lex specialis derogad legi generali*. Komisioni gjykon, se për sa kohë që *lex specialis* e ka rregulluar mënyrën e paraqitjes së ankimeve dhe afateve në lidhje me to, duke përcaktuar qartë dhe në mënyrë eksplicite që afatet e ankimit fillojnë nga dita kur ka ndodhur ngjarja (sipas rastit publikimi i njoftimit të kontratës, publikimi i njoftimit të fituesit/anulimit ose njoftimi i vendimit të përzgjedhjes së kandidatëve pas fazës së parakualifikimit në rastin e procedurës me faza) do të merren në konsideratë parashikimet e përcaktuara nga ligji i prokurimit publik si *lex specialis* mbi lëndën lidhur me llogaritjen e afateve të ankimit.

III.3.8. Sa më sipër arsyetuar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se ankesa e dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues, nuk ka përmbushur detyrimin për ndjekjen e afateve ligjore të ankimit, ndaj përbën shkak për mospranimin e ankesës nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik. Komisioni i Prokurimit Publik rithekson bindjen e tij, se për shkak të specifikës së prokurimeve publike, respektimi i afateve, është i një rëndësie thelbësore e me ndikim të drejtpërdrejtë në efikasitetin e procedurës, ndaj edhe i qëndron strikt rregullit të parashikuar nga ligji i prokurimit publik si *lex specialis* mbi lëndën.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

#### **Vendos:**

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “Armand Sinani” PF, për procedurën e prokurimit “Procedurë e kufizuar”, me Nr. REF-67127-04-25-2023, me objekt: “Blerje këpucë për Gardën e Republikës” me fond limit **29,995,279** (njëzet e nëntë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e pesë mijë e dyqind e shtatëdhjetë e nëntë) lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 16.05.2023 nga autoriteti kontraktor, Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara.

2. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Gentian Sadiku” PF për procedurën e mësipërme të prokurimit.
3. Autoriteti kontraktor të anulojë procedurën e mësipërme të prokurimit dhe me rihapjen e procedurës të ketë parasysh konstatimet e mësipërme të bëra nga Komisioni i Prokurimit Publik.
4. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
5. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomikë “Armand Sinani” PF.
6. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Gentian Sadiku” PF.
7. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
8. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

## **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Nënkryetar**

**Anëtar**

**Fiorent Zguro**

**Kreshnik Ternova**

**Kryetar  
Jonaid Myzyri**